

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

4

Kosovë 2008

Zhvillimi rural dhe siguria e produkteve ushqimore

Parathënie

Frode Mauring

Përfaqësues rezident i UNDP-së

Zhvillimi rural dhe siguria e produkteve ushqimore

Ky është numri i katërt i buletinit elektronik të quajtur Zhvillimi dhe tranzicioni – botim ky i Kosovës i një publikimi rajonal, të cilin që nga viti 2006 është duke e botuar Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në bashkëpunim të ngushtë me London School of Economics (LSE). Në numrin e parë u botuan artikuj për varfërinë dhe zhvillimin, i dyti u përqendrua në mendimet e akademikëve dhe profesionistëve për konfliktin dhe zhvillimin, ndërsa në numrin e tretë u analizuan çështjet lidhur me zhvillimin e sektorit privat në Kosovë. Ndërsa, tema e këtij numri është siguria e produkteve ushqimore dhe zhvillimi rural.

Buletini Zhvillimi dhe tranzicioni ka për qëllim lehtësimin për partnerët e UNDP-së dhe për qytetarët në përgjithësi të diskutimeve dhe debateve të orientuara në politika lidhur me atë se si natyra, ndryshimi, si dhe sfidat e zhvillimit e të tranzicionit ndërldihen në aktivitetet e UNDP-së, të cilat kanë për qëllim trajtimin e sfidave të rëndësishme të Kosovës së sotme. Fushat e theksit të veçantë përfshijnë zhvillimin njerëzor, zbutjen e varfërisë, Objektivat zhvillimore të mijëvjeçarit dhe strategjitë për zvogëlimin e varfërisë. Jo të gjitha pikëpamjet e shprehura në buletin janë të UNDP-së, ku qëllimi i buletinit është që më shumë të inkurajojë debatin e hapur rreth çështjeve që UNDP-ja i konsideron të rëndësishme.

Ky numër përfshinë artikujt që analizojnë aspekte të ndryshme të zhvillimit rural dhe të sigurisë së ushqimit nga pikëpamja e përgjithshme e Evropës Juglindore (EJ) dhe e Bashkësisë së Shteteve të Pavarura (BShP) të ish-Bashkimit

Sovjetik përmes kontributeve të ekspertëve ndërkombëtarë në buletin elektronik Zhvillimi dhe tranzicioni të Qendrës rajonale të UNDP-së në Bratisllavë, si dhe përmes kontributeve të ekspertëve kosovarë që punojnë për organizatat zhvillimore, shoqërinë civile dhe për sektorin privat.

Artikujt nga ekspertët ndërkombëtarë analizojnë çështje të ndryshme, duke filluar me pyetjen “A është duke vdekur fshati?”, përmes të cilit autori analizon ndryshimet në viset rurale në Evropën Qendrore dhe Lindore, dhe përfundon se imazhi i përhapur i fshatit që zvogëlohet dhe po vdes, fati i të cilit është i kundërt me dinamikën e qytetit, nuk është edhe aq i zymtë. Autori më shumë e përkrahë idenë se mendimet lidhur me vdekjen e fshatit mund të jenë të zmadhuara. Në artikullin tjetër analizohet se si angazhimi i shoqërisë civile dhe bashkimi i tyre në shoqata i kontribuojnë zhvillimin bujqësor dhe rural në rajonin e EJ-së dhe të BShB-së. Në bazë të studimeve të rastit në Shqipëri, Bullgari dhe në Republikën Çeke, në këtë artikull mbrohet ideja se angazhimi i shoqërisë civile luan rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin rural, dhe se në të ardhmen mund të bëjë kontribute të rëndësishme, duke marrë parasysh investimet e duhura në shoqërinë civile. Në artikullin tjetër shqyrtohet përkrahja e BE-së për zhvillimin rural në një BE të zgjeruar dhe planet e reja për reformë. Kontributi i fundit nga perspektiva ndërkombëtare shqyrton efektet e mundshme afatmesme të rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore në dallimet mes viseve rurale dhe atyre urbane, duke i shtyrë familjet e rrezikuara urbane në varfëri dhe duke i dhënë rast të ri prodhuesve ruralë të produkteve ushqimore që të ikin nga e njëjta.

Artikujt e shkruar nga perspektiva e Kosovës po ashtu janë mjaft sfidues dhe interesant, ku analizojnë një vistër çështjesh lidhur me zhvillimin rural dhe me çmimet e produkteve ushqimore. Duke hulumtuar efektin e çmimeve në rritje të

Përmbajtja

Parathënie: Zhvillimi rural dhe siguria e produkteve ushqimore	Frode Mauring	1
Marrëdhënie e dobët? Fondet strukturore të BE-së dhe zhvillimi rural	John Bachtler	2
Nismat qytetare dhe zhvillimi rural	Thomas Sikor	4
Zhvillimi rural, çmimet e ushqimit dhe dallimet rajonale	Susanne Milcher dhe Kitti Kiss	5
A po vdes fshati?	Andrew Cartwright	9
Çmimet në rritje të produkteve ushqimore dhe mundësitë për rritjen e prodhimit bujqësor	Nick Maddock dhe Levent Koro	11
Stimulimi i industrisë së re për përpunimin e produkteve ushqimore në Kosovë	Nick Maddock dhe Levent Koro	13
Ndikimi i kontrollit të ushqimit në zhvillimin bujqësor dhe në sigurinë e ushqimit në Kosovë	Agim Rysha	15
Zhvillimi Rural në Kosovë	Alban Zogaj, MSc	17
Në kërkim të një modeli zhvillimor për të varfrit: investimet publike, bujqësia dhe varfëria rurale	Artan Loxha	19

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

produkteve ushqimore dhe të perspektivës për prodhimin ushqimor në Kosovë, në artikullin e parë ceket se edhe pse efektet afatshkurtra të rritjes qartazi kanë efekte negative në varfëri, posaçërisht për të varfrit urbanë që kryesisht janë konsumatorë të këtyre produkteve, nëse zbatohen politikat e drejta efektet e tij në të varfrit ruralë mund të jenë të kundërta. Në artikullin pasues autorët shqyrtojnë mënyrat për rritjen e prodhimit të produkteve ushqimore, duke stimuluar industrinë e përpunimit të produkteve ushqimore në Kosovë. Ngjashëm me këtë, në artikullin tjetër analizohet infrastruktura rurale dhe disa nga problemet e tjera me të cilat ballafaqohen viset rurale në Kosovë, si dhe jepen disa rekomandime për një zhvillim të shpejtuar.

Rregulloret për standardet e sigurisë dhe ruajtjes së ushqimit mund të mos konsiderohen si thelbësore për zhvillim, megjithatë ato janë shumë të rëndësishme për ndërtimin e besimit të konsumatorëve dhe, në një afat të gjatë, edhe për zhvillimin rural. Në këtë drejtim, artikulli për çështjen e sigurisë së ushqimit analizon gjendjen e tanishme në Kosovë dhe atë se çka duhet të bëhet me qëllim të përmirësimit të kontrollit të cilësisë dhe të ruajtjes së produkteve ushqimore.

Në artikullin e fundit paraqitet një analizë e shkëlqyeshme e trendëve botërorë në zhvillimin rural dhe mënyra e ndikimit të tyre në Kosovë. Autori shqyrton nëse supozimi se favorizimi i politikave industriale në një afat të gjatë do të çon drejt zhvillimit të orientuar kah të varfrit dhe të zhvillimit rural, si dhe sugjeron se zhvillimi që vjen nga bujqësia është më i efektshëm në stimulimin e kursimeve për kategoritë më të varfra, sesa zhvillimi që vjen nga sektorët jobujqësorë.

Duke i falënderuar autorët për kontributet e tyre, ju dëshiroj një lexim të këndshëm dhe shpresoj se do t'i pëlqeni analizat dhe çështjet që janë ngritur. Pasi këta artikuj i shqyrtojnë trendët globalë që ndikojnë Kosovën, ata po ashtu ofrojnë një bazë të mirë për debate për atë sesi Kosova mund të

reagojë ndaj këtyre sfidave me qëllim të maksimalizimit të përfitimeve dhe të minimalizimit të efekteve negative.

Vërejtje: Pikëpamjet e shprehura këtu nuk i pasqyrojnë domosdo ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara.

Marrëdhënie e dobët? Fondet strukturore të BE-së dhe zhvillimi rural

John Bachtler

Në pjesën më të madhe gjatë 50 viteve të fundit, për Komunitetin Evropian zhvillimi rural ka qenë një nga lëmit e politikave të cilat janë neglizhuar. Me përgjegjësitë e ndara në mes të politikës së përbashkët bujqësore (PPB) dhe politikës së kohezionit, i vendosur në plan të dytë në krahasim me politikat tjera, zhvillimit rural i ka munguar një politikë e qasjes koherente dhe burimet. Hyrja e shteteve të reja në BE ka sjellë sfida të reja.

Zgjerimet lindore në vitin 2004 dhe 2007 kanë krijuar larmi edhe më të madhe në strukturat bujqësore të BE-së. Kjo është qartë e dukshme në shkallën e pazhvillimit të viseve rurale, në pjesëmarrjen dukshëm më të madhe të bujqësisë në punësim dhe BPV (në krahasim me 15-en e BE-së) dhe në numrin e madh të fermave të vogla familjare të cilat janë mjet jetese.¹ Përgatitja për zhvillimin rural të financuar nga BE-ja është mbështetur përmes fondeve për të mbështetur hyrjen në BE (të para-hyrjes) Phare dhe SAPARD. Edhe pse burimet kanë qenë shumë të kufizuara, ato prapëseprapë kanë ofruar përvojën e parë në përgatitjen e programeve zhvillimore rajonale dhe rurale, krijimin e sistemeve ad-

Tabela 1: Alokimet e PPB-së zhvillimit rural për periudhën 2007-13

Shtetet anëtare	Pagesat e përgjithshme të skemës së vetme për pagesa dhe Shtyllës së II-të, (milion euro)	Shtylla II si % e Pagesave të përgjithshme	Tatimet e zhvillimit bujqësor (përqindja e shumave të përgjithshme të pranuar)			
			Mjedisi dhe fshati	Konkurrenca e bujqësisë dhe pylltarisë	Cilësia e jetës rurale dhe larmia ekonomike	Krijimi i kapacitetit lokal
15-ja e BE-së	19,830	21%	6%	12%	2%	1%
Shtetet e reja anëtare	6423	52%	21%	19%	10%	2%

Burimi: Duke u bazuar në RLG (2007) *PPB-ja në 27 shtete anëtare: zbatimi dhe vizioni i politikës së përbashkët bujqësore*, Raad voor het Landelijk Gebied (Këshilli për vendet rurale), Utrecht. Të dhënat janë mesataret e papeshuara kombëtare.

¹ Nemes G (2005) *Politikat e zhvillimit rural në Evropë*, Dokumente për diskutim 2005/5, Instituti ekonomik, Akademia Hungareze e Shkencave, Budapest.

ministrative dhe njoftimin e ndërmarrjeve dhe fermerëve me llojet e reja të ndihmës.² Pas hyrjes, shtetet e reja anëtare u kualifikuan për mbështetje për zhvillimin rural, sipas politikës së kohezionit dhe PPB-së. Në periudhën 2004-06, shteteve të reja anëtare u janë vënë në dispozicion shuma relativisht të vogla të financimit struktural dhe të kohezionit, të cilat kapnin shumën prej 69 milionë euro në Estoni deri në 1.1 miliard euro në Poloni. Sidoqoftë, nga viti 2007 e tutje, shtetet e reja anëtare kanë përfitur nga politika e kohezionit në baza të njëjta sikurse edhe 15-ja e BE-së (megjithëse me një 'kufizim të caktuar' për shumatat e marra).

Zgjerimet lindore të BE-së korrespondojnë me zhvillimin dhe krijimin e kornizave të reja planifikuese për zhvillimin rural edhe për politikën e kohezionit e edhe mbështetjen e Shtyllës së II-të të PPB-së për zhvillim rural. Për periudhën 2007-13, të dy kornizat marrin Strategjinë e Lisbonës si pikënisje, duke u përqendruar në rritje, vende të punës dhe qëndrueshmëri. Sidoqoftë prioritetet për këto dy lëmi të politikave pastaj devijojnë nga njëra tjetra. Përderisa është krijuar Fondi i ri Bujqësor Evropian për Zhvillim Rural (FBEZH-R) për zbatimin e Mbështetjes së Shtyllës së II-të të PPB-së, administrimi i tij është plotësisht i ndarë nga fondet strukturore si dhe i mungon përqendrimi në kohezionin territorial. Meqë politika e kohezionit mban pagesën për zhvillim rural përmes fondeve strukturore, shtetet anëtare duhet të zhvillojnë mekanizmat e tyre të bashkëpunimit për të siguruar koherencë në mes të dy mekanizmave.³

Një nga çështjet më të diskutueshme të zgjerimit ka qenë vendimi i 15-es së BE-së për të zbatuar gradualisht financimin e PPB-së për shtetet e reja anëtare gjatë periudhës 2004-13. Si pasojë e kësaj, shtylla e zhvillimit rural është shumë më e rëndësishme në shtetet e reja anëtare sesa në 15-en e BE-së. Sikurse paraqet edhe Tabela 1, alokimet e përgjithshme për shtetet e reja janë konsiderueshëm më të vogla sesa për 15-en e BE-së: për shembull, Polonia merr më pak se gjysma e asaj që ndahet për Francën. Për më tepër, pjesa e zhvillimit rural në shpenzimin e përgjithshëm të PPB-së është konsiderueshëm më e lartë,⁴ duke lëvizur prej 37-38 për qind në Hungari dhe Republikë Çeke, deri në 69 për qind në Estoni, Letoni dhe Rumania dhe 79 për

qind në Maltë. Kjo krahasohet me pjesën për zhvillim rural prej 6-10 për qind në Belgjikë, Danimarkë, Francë, Holandë dhe Mbretëri të Bashkuar. Shumë shtete të reja anëtare po ashtu i dedikojnë një pjesë më të madhe të alokimeve të tyre për zhvillim rural lëmive të cilat nuk përfshijnë fermat.

E ardhmja e politikës së kohezionit

Është shumë herët për të nxjerrë ndonjë konkluzion sa i përket harxhimeve të BE-së për zhvillim rural në shtetet e reja anëtare. Gjatë periudhës 2004-06 fondet strukturore janë zotuar shpejt, por absorbimi i këtyre zotimeve ka qenë më i ngadalshëm sesa është pritur. Kornizat institucionale dhe rregulatore nuk kanë qenë gjithmonë adekuate — problem i cili vazhonte në periudhën 2007-13. Financimi i disa programeve zhvillimore është vonuar për shkak të ndryshimeve të shpeshta në kriteret për kualifikim dhe nga komplikimet tjera administrative. Kapaciteti administrativ në nivelin kombëtar është treguar të jetë problem në shtetet ku autoritet rajonale nuk ekzistojnë ndërsa ato lokale kanë personel dhe burime financiare të kufizuara. Këto shtete duket se kanë kufizuar pjesëmarrjen e komunave, komuniteteve, ndërmarrjeve rurale të vogla dhe të mesme dhe fermerëve më të vegjël në programet zhvillimore të BE-së.⁵

Edhe pse periudha 2007-13 është më pak se dy vite e vjetër, debati tashmë ka filluar për politikën e BE-së nga viti 2014 e më tej. Në shtator 2007, Kryetari i Komisionit Jose Manuel Barroso ka filluar rishikimin e buxhetit të BE-së, përfshirë edhe konsultimin publik për objektivat dhe prioritetet e politikave. Paralelisht me këtë, është bërë edhe një konsultim për të ardhmen e politikës së kohezionit, si dhe është ndërmarrë një kontroll i gjendjes së PPB-s. Presione të forta nga shtetet anëtare, institucionet evropiane, autoritetet nën-kombëtare dhe interesat tjera për rritjen e shpenzimeve nga BE-ja për mjedisin, energjinë dhe konkurrencën, hulumtimet dhe njohuritë kanë dalë gjatë këtij procesi. Po ashtu ka edhe mbështetje të konsiderueshme për reorientimin e shpenzimeve të PPB-së në drejtim të zhvillimit rural.⁶ Mungesa e perceptuar e koherencës së politikave të BE-së dhe ndarja e përgjegjësiave për zhvillim rural në mes të FBEZH-R-së dhe fondeve strukturore, po ashtu mbesin shqetësime kryesore.

² Roze M (2007) *Anëtarët e rij të BE-së dhe sfidat me të cilat ballafaqohet politika evropiane rurale dhe bujqësore* Prezantim në konferencën 'Perspektiva e PPB-së në shtete e reja anëtare' Valmieria, Letoni, maj 2005.

³ Davies S, Bachtler J, Yuill D, Gross F dhe Vironen H (2008) *Diskutim strategjik për të ardhmen e politikave regjionale dhe rajonale të BE-së*, Dokument për informim për seminarin Sub Rosa, 29 shkurt – 1 mars 2008, Bruksel.

⁴ RLG (2007) *PPB-ja në 27 shtetet anëtare: zbatimi dhe vizioni i politikës së përbashkët bujqësore*, Raad voor het Landelijk Gebied (Këshilli për vendet rurale), Utrecht. <http://www.rlg.nl/cap/introduction.html>.

⁵ Meyers W H, Kazlauskienė N, Naujokienė R dhe Kriščiukaienė I (2006) *Mësimet e nxjerra dhe sfidat në programet e zhvillimit rural në Lituani*, Žemės Ūkio Mokslai, Nr 1 (priedas), 1-8. Mażwa M dhe Sendrowski (2006) *Krijimi dhe shfrytëzimi i fondeve strukturore bujqësore në Poloni*, Mbështetja për Fondacionin për Bujqësi, www.fundacja-wpr.pl. Cunder T (2007) Roli i politikës për zhvillim rural në menaxhimin e mjedisit dhe tokës në Slloveni, *Zhurnali i Bujqësisë Qendrore Evropiane* 8(2), 237-242.

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

Ndryshimet kryesore ndaj prioriteteve të BE-së nuk do të ndodhin brenda një nate, meqë ato duhet t'u përshtaten interesave kombëtare të 27 shteteve anëtare. Sidoqoftë rishikimi i buxhetit ka gjasë të shoh një theks më të madh në zhvillimin rural, duke u bazuar në një qasje më të gjerë ndaj ekonomisë rurale dhe një menaxhimi më të integruar të shpenzimeve në zhvillimin rural.

John Bachtler është profesor i Studimeve të Politikave Evropiane dhe Drejtor i Qendrës për Hulumtimin e Politikave Evropiane, Universiteti Strathclyde, Glazgov.

Nismat qytetare dhe zhvillimi rural

Thomas Sikor

Që nga viti 1990, bujqësia ka përjetuar probleme serioze në Evropën qendrore dhe atë lindore (EQL) dhe në Komonuelthin e shteteve të pavarura (CIS). Prodhimet dhe/ apo të ardhurat nga pjesa më e madhe e të korrurave dhe e shumicës së vendeve pësuan rënie gjatë viteve 1990. Veç kësaj, bujqësia nuk i ka adresuar vetvetiu interesat konsumuese të zonave rurale, siç janë rekreacioni dhe mbrojtja e natyrës. Si përfundim, bujqësia nuk ka qenë mjet i zhvillimit rural, duke i kontribuar përqendrimin të varfërisë në zonat rurale, që vërehej kudo në EQL-në dhe CIS-in.

Ndryshimet dhe vazhdimësitë, në shtete dhe tregje përforcojnë këto probleme. Megjithëse ministrinë e bujqësisë janë tërhequr me të madhe nga përfshirja e drejtpërdrejtë në prodhim dhe marketing, ato vazhdojnë që t'i ushqejnë në mendjet e tyre qëndrimet përkrahëse ndaj prodhuesve bujqësorë. Tregjet janë krijuar për pjesën më të madhe të prodhimeve dhe shërbimeve bujqësore, por shumë shpesh mungojnë për prodhimet e tokës dhe për ato më të specializuara. Shumë tregje janë nën kontrollin e një tregtari të vetëm apo një grupi të vogël të tyre, duke u ofruar prodhuesve rural çmime të papërshtatshme.

Studimet e rasteve nga Shqipëria, Bullgaria dhe Republika Çeke sugjerojnë se angazhimi qytetar mund të luaj rol vendimtar në adresimin e këtyre çështjeve të zhvillimit rural.

Grupet e shfrytëzuesve të ujit në Bullgari

Infrastruktura e ujitjes në Bullgari është ndërtuar në periudhën e socializmit për bujqësi në shkallë të gjerë. Koopera-

tivat koordinonin shpërndarjen e ujit në nivelin lokal dhe i mirëmbanin kanalet sekondare. Meqë fermat e sotme të shkallës së ultë nuk përshtaten me furnizim me ujë të shkallës së gjerë, prodhuesit e vegjël duhet të mbështeten në shpërndarjen e ujit dhe mirëmbajtjen e kanaleve sekondare.

Shumë prodhues të vegjël në rajonin e Plovdivit i kanë krijuar grupet e shfrytëzuesve të ujit si reagim ndaj këtyre problemeve. Grupet prej 10 deri në 50 prodhues të vegjël e koordinojnë shpërndarjen e ujit, veprojnë së bashku me kompaninë e ujitjes dhe mirëmbajnë kanalet sekondare. Në raste të tjera kryetarët e komunave e udhëheqin koordinimin e shpërndarjes së ujit dhe mirëmbajtjen, megjithëse ata nuk e kanë mandatin përkatës ligjor.

Këto grupe të shfrytëzuesve të ujit tregojnë se si nismat qytetare mund të ndihmojnë në tejkalimin e problemeve të hapura të zhvillimit rural. Mirëpo, përderisa menaxhimi kolektiv i ujit sipërfaqësor është më i mirë për sistemet e ujit dhe kualitetin e tokës sesa puset individuale dhe pompat, grupet e shfrytëzuesve të ujit janë formuar vetëm në disa fshatra. Zgjerimi i tyre është i kufizuar nga mungesa e përgjithshme besimit shoqëror, respekti i ultë ndaj shumë zyrtarëve qeveritar, mosnjohja e modeleve të suksesshme të kooperimit dhe aftësia e dobët organizative. Veç kësaj, sipas sistemit ligjor të Bullgarisë, disa nga veprimet e ndërmarra nga ana e grupeve të shfrytëzuesve të ujit dhe të kryetarëve të komunave janë joligjore, ndërsa investimi në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemeve ujitëse shpesh është joadekuat.

Kur është miratuar legjislacioni për përkrahjen e bashkëpunimit për ujitje, nuk ka qenë gjithmonë në gjendje të ndërlihet me nismat ekzistuese në terren. Shumë zyrtarë në ministrinë e bujqësisë dhe kompaninë shtetërore të ujitjes kanë rezistuar zbatimin e ligjit mbi Shoqatat e Shfrytëzuesve të Ujit, të vitit 2001, duke qenë se ai për ta nënkuptonte humbjen e kontrollit. Vetëm një shfrytëzues i ujit është regjistruar gjatë vitit të parë të zbatimit. Ngjashëm me këtë, tregjet e ujit, të cilat paraqiten, nuk mund t'i zëvendësojnë funksionet e grupeve të shfrytëzuesve të ujit. Furnizuesit e varur nga tregu nuk janë të gatshëm për t'i shërbyer prodhuesit e vegjël për shkak të shpenzimeve të larta dhe problemeve monitoruese. Kompania e ujitjes në Plovdiv në të kaluarën iu përgjigj presioneve financiare thjeshtë duke ua shkurtuar shërbimet prodhuesve të vegjël.

⁶ *Reformimi i buxhetit, ndryshimi i Evropës*, Prezantim nga Dalia Grybauskaitė, Komisionar për çështje financiare dhe buxhet për anëtarët e Dhomës së Lordëve, Dhomës së Komuneve dhe Parlamentit Evropian, Londër, 3 korrik 2008. Një lloj reorientimi i PPB-së tashmë është propozuar gjatë rishikimit të gjendjes momentale të tij, edhe pse kjo është shumë modeste me një rritje prej vetëm 8 % në transferimin e pagesave të drejtpërdrejta buxhetit për zhvillim rural.

Ndihma ligjore në të drejtat mbi tokën në Shqipëri

Derisa prodhuesit bujqësorë në Shqipëri, në parim i kanë fituar të drejtat ligjore mbi tokën, shumica ende duhet që t'i fitojnë të drejtat formale mbi tokën, duke qenë se ata i kanë vetëm certifikatat e përkohshme mbi tokën. Pak transaksione të pronës së paluajtshme janë regjistruar në shërbime të kadastrave. Kontestet pronësore janë të zakonshme, por pak nga to mbërrijnë në gjykata. Ndonëse shumë konteste janë zgjidhur me ndërmjetësimin e të afërmeve apo zyrtarëve të qeverisjes lokale, mjaft nga ato mbesin. Ndihma ligjore private është e kushtueshme dhe vështirë gjendet në zonat rurale. Derisa autoritetet lokale mund të kenë përgjegjësi ndaj komuniteteve lokale, ata posedojnë ekspertizë të pakët për çështjet ligjore dhe ligjin duke qëndruar të ndërlidhur me qeverinë qendrore. Gjykatat e kanë mandatin ligjor për zgjidhjen e kontestëve pronësore, mirëpo procedurat gjyqësore mund të jenë mjaft të zgjatura. Dhe përderisa shërbimi i kadastrës Shqiptare (Sistemi i regjistrimit të pasurisë së patundshme) ka pranuar ndihmë të madhe nga USAID-i, Banka Botërore dhe Komisioni Evropian, është agjenci e centralizuar në masë të madhe e cila nuk qe e aftë apo nuk ishte e gatshme që t'ia sigurojë ndihmën e nevojshme ligjore popullatës rurale.

Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve (ZMQ-ja) në Tiranë i ka plotësuar këto zbrazëtira duke e ofruar ndihmë ligjore për të drejtat mbi tokën. Kjo OJQ (me përkrahjen e donatorëve ndërkombëtarë) i ofron ndihmën ligjore çdonjërit që e kërkon një të tillë, përfshirë kontestet pronësore. Duke e shtuar vetëdijësimin publik lidhur me të drejtat ligjore dhe duke ofruar ndihmë ligjore, klinika ligjore e ZMQ-së u ka siguruar përkrahje vendimtare popullatës rurale, shumica nga të cilët nuk kanë vend tjetër për t'iu hyrë marrëveshjeve, nganjëherë në sistemin e administrimit të tokës të padepërtueshëm dhe që nuk reagon. Veç sigurimit të ndihmës vendimtare për komunitetet rurale, të cilën nuk mund ta ofrojë as shteti e as sektori privat, ZMQ-ja e ka sjellë gjithashtu edhe përvojën e vet nga puna me mosmarrëveshjet tokësore për ta mbartur në krijimin e politikave kombëtare.

Një OJQ agro-mjedisore në Republikën Çeke

Aktivitetet bujqësore tradicionale në tokat margjinale, në Republikën Çeke, u bënë jofitimprurëse pas viti 1989, kur çmimet e prodhimit u zbritën në krahasim me çmimin e lëndës së parë dhe shërbimeve. Në të njëjtën kohë, interesimi i ri për rekreacionin rural dhe mbrojtjen e natyrës e bëri qeverinë që ta zgjerojë sistemin e zonave të mbrojtura. Si përfundim, fermerët e vegjël të cilët prodhonin në tokat margjinale u ndjenë të shtrydhur ndërmjet fitimeve në rënie dhe shtimit të normave të kufizimit të përdorimit të tokës. Agjencitë qendrore shtetërore që merreshin me

këta prodhues të vegjël nuk janë kujdesur gjithmonë për interesat e tyre: agjencitë bujqësore kryesisht u bëjnë shërbime fermerëve të mëdhenj, derisa agjencitë e mjedisit më shumë fokusohen në mbrojtjen e peizazhit sesa në nevojat e prodhimit të të hyrave të komunitetit. Dhe përderisa autoritetet lokale interesohen më shumë në zhvillimin rural, atyre nganjëherë u mungon ekspertiza teknike dhe aftësia për ndryshime.

Disa OJQ që merren me konservim, kanë kërkuar për t'i adresuar këto probleme duke u siguruar shërbime të menaxhimit të peizazhit fermerëve të vegjël në Zonën e Peizazhit të Mbrojtur "White Carpathians".

Qendra e Informatave në Moravke Kopanice ka:

- promovuar produkte të fermave të cilat janë të ndjeshme ndaj mjedisit, duke e krijuar një emërtim për mallrat e prodhuara lokale dhe duke i identifikuar daljet në tregjet konkrete
- ndikuar në agjencitë e qeverisë qendrore në emër të prodhuesve të vegjël; dhe
- inkurajuar prodhuesit lokal që t'i formojnë shoqatat për marketing.

Angazhimi qytetar nëpërmjet punës së Qendrës për Informim vjen si pasojë e sjelljes së qasjeve të reja ndaj zhvillimit rural në një rajon që vuan nga rënia ekonomike dhe migrimi i pazakonshëm.

Përfundimi

Përderisa 'eksplozimi' i sektorit të OJQ-ve në rajon, që nga fundi i viteve të 1990-ta, mund të ketë qenë i përqendruar në zonat urbane, disa OJQ janë interesuar për zhvillimin rural. Nismat qytetare gjithashtu marrin formën e grupeve *ad hoc* të krijuara për qëllime specifike, të cilat mund të mos kenë qenë të regjistruara formalisht dhe t'iu kenë shmanjur syve të analistëve të OJQ-ve. Nismat e tilla mund t'i sjellin kontribute vendimtare zhvillimit rural, duke i plotësuar zbrazëtirat e mbetura nga tërheqjet e shteteve dhe tregjet e pazhvilluara. Ato i adresojnë problemet e përbashkëta të popullatës rurale, ku qasjet bashkëpunuese janë të favorshme. Avantazhet e bashkëpunimit janë të dukshme në ujitje, për shkak të varësive të ndërsjella teknike në sistemet ujitëse të shkallës së gjerë të ndërtuar në socializëm. Ende nismat qytetare gjithashtu nxjerrin përfitime në fushat tjera, si në marketing dhe çështjet ligjore. Kjo është posaçërisht e vërtetë për lëvizjet fillestare drejt mënyrave të reja të bujqësisë, si bujqësia në mjedisin e ndjeshëm dhe prodhimi i specialiteteve. Në të njëjtën kohë, këto nisma do të përfitojnë nga investimet e përshtatshme në shoqërinë qytetare për t'i tejkaluar caqet e ndikimit dhe kufijtë, dhe për ta përforcuar aftësinë teknike, efektshmërinë organizative, dhe përgjegjësinë. Ata gjithashtu do të përfitojnë

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

nga sistemet ligjore më shumë përkrahëse dhe mundësisë më të madhe për financimet nga qeveria.

Thomas Sikor Ligjërues i Lartë për Studime Zhvillimore pranë Universitetit të Anglisë Lindore (Mbretëri e Bashkuar).

Referencat

Penov, I. 2004. Përdorimi i Ujit për Ujitje në Rajonin Plovdiv të Bullgarisë gjatë Tranzicionit. *Menaxhim i Mjedisit* 34(2): 304-313.

Prazan, J., Ratering, T., Krupalowa, V., Lowe, P. dhe A. Zellei. 2003. Mbrojtja e Peizazheve me Vlera të Larta Natyrore në një Evropë të Zgjeruar: Një Analizë Krahasuese e Republikës Çeke, Hungarisë dhe Sllovenisë. Budapest: Ushqimi dhe Organizata Bujqësore.

Sikor, T. 2005. Prona Rurale dhe Legjislacioni Agro-mjedisor në Evropën Qendrore dhe Lindore. *Sociologia Ruralis* 45(3): 187-201.

Stahl, J., Sikor, T. dhe Dorondel. 2008. Transparence de l'administration foncière en Albanie et en Roumanie. *E gatshme në Opsionet Méditerranéennes*.

Theesfeld, I. 2004. Kufizimi i Aksioneve Kolektive në një Ekonomi Tranzitore: Rasti i Sektorit të Ujitjes në Bullgari. *Zhvillimi Botëror* 32(2): 251-272.

Theesfeld, I. 2008. Degradimi i Sistemit të Ujitjes në Bullgari: Kundërshtimi i publikut. Pp. 45-59 në Sikor, T. (ed.) *E Hapura dhe Privatja në Qeverisjen e Resurseve Natyrore: Një Ndarje e Rreme?* Londër, Earthscan.

Zhvillimi rural, çmimet e ushqimit dhe dallimet rajonale

Susanne Milcher dhe Kitti Kiss

Zakonisht vendet në të varfra të Evropës lindore dhe Azisë qendrore janë ato me pjesën më të madhe të popullsisë rurale,⁷ meqë pjesë të mëdha të popullsisë jetojnë në viset rurale to cilat nuk i kontribuojnë aq shumë

BPV-së. Dallimet rurale-urbane nuk janë të ndërlidhura vetëm me të ardhurat më të ulëta në viset rurale; ato po ashtu pasqyrojnë përjashtimin nga burimet, mundësitë për punësim dhe shërbimet sociale në viset rurale. Rritja e çmimeve të ushqimit kohëve të fundit ndikon në mënyra të ndryshme tek popullsia rurale dhe ajo urbane. Ky artikull shqyrton efektet e mundshme afatmesme të rritjeve të çmimeve të ushqimit në dallimet rurale-urbane brenda rajonit.

Dallimet rurale-urbane dhe barrierat ndaj zhvillimit rural

Pothuajse në të gjitha vendet e rajonit, shkallët e varfërisë janë më të larta në vendet rurale sesa në ato urbane (shih Tabelën 1).⁸ Për më tepër, pavarësisht së paku një dekade të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë në vendet urbane e edhe ato rurale është afër vijës së varfërisë (veçanërisht vendet e pavarura të Komonuelthit). Prandaj edhe një zvogëlim i vogël i të ardhurave do të mund t'i shtynte shumë ekonomi familjare të rrezikuara drejt varfërisë.

Në përgjithësi zvogëlimi i varfërisë ka qenë më shumë i suksesshëm në zonat urbane sesa ato rurale, meqë ekonomitë familjare në zonat urbane kanë më shumë qasje në punësim, arsim dhe shërbime shëndetësore dhe mbështetje nga donatorët të cilat janë të vendosur në këto zona.⁹ Të varfrit e zonave urbane kanë përfituar më shumë nga ngritja ekonomike e rajonit, sepse ata janë më mirë të integruar në tregun formal të punës. Progresi më i ngadalshëm në zvogëlimin e varfërisë në zonat rurale pasqyron zhvillimin më të ngadalshëm të bujqësisë dhe një qasje më të dobët në mundësitë për punësim jashtë fermave dhe shërbimet sociale, dhe në infrastrukturën fizike dhe sociale, tregjet, tokë dhe kredi. Përgjigjja më e vogël ndaj rritjes ekonomike në zonat rurale ka rezultuar në pabarazi të vazhdueshme apo të ashtuquajturat kurtet e varfërisë, duke pasqyruar barrierat të rëndësishme institucionale ndaj zhvillimit social.¹⁰

Varfëria rurale po ashtu pasqyron faktin se bujqësia mbetet burim qendror i jetesës në zonat rurale.¹¹ Mundësitë

⁷ Në të tre vendet e rajonit të klasifikuara nga Banka Botërore si vende me të hyra të ulëta (Kirgistan, Taxhikistan dhe Uzbekistan), 63-75 për qind e popullsisë jeton në viset rurale. Në të gjitha vendet tjera, përqindja e popullsisë është nën 55 për qind (Organizata Botërore e Shëndetësisë, Baza e të dhënave WHOSIS: <http://www.who.int/whosis/data/>, gusht 2008).

⁸ Të dhënat për varfërinë të paraqitura këtu janë nga baza rajonale e të dhënave e bankës Botërore, e cila është burimi i vetëm i të dhënave të krahasueshme për varfërinë në rajon. Sipas metodologjisë së Bankës Botërore, varfëria përcaktohet si jetesë me më pak se \$PPP 2.15/ditë dhe ata që jetojnë me më pak se \$PPP 4.30/ditë konsiderohen si të rrezikuar. Për më tepër informata për këtë hulumtim, shih Banka Botërore (2005), *Rritja, varfëria dhe pabarazia – Evropa lindore dhe ish Bashkimi Sovjetik*.

⁹ Ibid.

¹⁰ Ibid., p. 95.

¹¹ Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) (2002), *Raport tranzicioni 2002 – Bujqësia dhe tranzicioni rural. Tranzicioni ekonomik në Evropën qendrore dhe lindore dhe vendet e pavarura të Komonuelthit*, f.90.

Tabela 1: Varfëria, rrezikshmëria dhe dallimet hapësinore

Vendi	Përqindja e popullsisë e cila jeton në varfëri (me më pak se \$PPP 2.15/ditë)				Përqindja e popullsisë së rrezikuar (e cila jeton me më pak se \$PPP 4.30/ditë)			
	Kapitali	Urbane tjera	Të gjitha urbane	Rurale	Kapitali	Urbane tjera	Të gjitha urbane	Rurale
Shqipëria	16	19	18	27	63	67	66	75
Armenia	35	57	46	57	86	94	90	96
Azerbajxhani	4	8	6	3	66	74	69	70
Bjellorusia	1	3	2	2	14	26	23	18
Bosnja dhe Hercegovina	2	6	4	4	21	39	38	33
Bulgaria	0	5	6	6	20	34	31	36
Estonia	4	5	5	5	21	27	24	28
Gjeorgjia	32	50	41	62	75	87	81	89
Hungaria	0	0	0	0	8	11	10	16
Kazakistani	2	14	13	31	29	57	55	79
Kirgistani	42	68	57	77	89	96	93	98
Letonia	1	3	2	5	7	19	12	27
Lituania	1	2	1	8	11	21	15	42
IRJ e Maqedonisë,	4	5	5	3	26	25	24	25
Moldavia	27	48	37	47	75	88	81	87
Polonia	2	2	2	3	20	22	22	36
Rumania	4	7	6	20	41	47	45	72
Federata Ruse	5	7	7	14	36	37	37	53
Serbia dhe Mali i Zi	6	4	4	9	36	37	35	51
Taxhikistani	54	73	67	76	89	96	93	97
Ukraina	0	1	1	2	11	20	20	28
Uzbekistani	4	43	34	55	39	83	73	93

Source: World Bank staff estimates using the ECA Households Surveys Archive, 2002-2004 (World Bank, 2005).

e punësimit jashtë fermave janë shpesh të kufizuara dhe kështu mbetet mbështetja tek punimi i tokës si mjet jetese. Për këtë arsye, ekonomitë familjare të ardhurat e të cilave varen vetëm nga bujqësia janë të rrezikuara nga varfëria në mënyrë të veçantë. Punësimi në bujqësi në disa nga vendet e pavarura të Komonuelthit me të ardhura të ulëta është shtuar së bashku me rimëkëmbjen ekonomike dhe shpesh shërben si rrjet joformal i sigurisë, meqë punëtorët në zonat rurale më lehtë janë në gjendje të kultivojnë ushqimin e tyre sesa punëtorët në zonat urbane. Në anën tjetër, niveli i ultë i mekanizimit bujqësor vazhdon të dobësojë produktivitetin e punës dhe të hyrat në zonat rurale.¹² Dhe përderisa mekanizimi i mëtejshëm dhe komercializimi mund të rrisin të hyrat e atyre punëtorëve në sektorin bujqësor të cilët mbesin të

punësuar, po ashtu ka mundësi të rezultojnë në shpërndarjen e barabartë të punës, zvogëlimin e të hyrave për punëtorët e papunë në zonat rurale dhe shtimin e pabarazisë në zonat rurale.¹³

Për këtë arsye zvogëlimi i qëndrueshëm i varfërisë rurale dhe i pabarazive kërkon zgjerimin e mundësive të punësimit në zonat rurale jashtë fermave. Sidoqoftë, perspektiva për rritje të punësimit në ferma dhe jashtë tyre është e kufizuar nga mungesa e investimeve në mjedisin rural, veçanërisht në formë të rrjeteve inferiore të komunikimit, infrastrukturës së varfër fizike, shërbime financiare të pazhvilluara dhe lidhje të dobëta tregu.¹⁴ Sipas Bankës Botërore, përderisa më tepër se 90 për qind e ekonomive familjare në zonat urbane në rajon kanë qasje në ujë,¹⁵

¹² Banka Botërore (2008), *Zgjimi i prosperitetit – Rritja e produktivitetit në Evropën Lindore dhe ish Bashkimin Sovjetik*, f.73-78.

¹³ Davis, Junior (2006). 'Mjetet e jetesës në viset rurale që nuk kanë të bëjnë me fermën në vendet në tranzicion: politikatat dhe çështjet që dalin nga kjo'. *eJade Zhurnal elektronik i ekonomive bujqësore dhe zhvillimore*, vëllimi 3, nr. 2, ff 180-224.

¹⁴ EBRD (2002), op.cit, f.92.

¹⁵ Raporti është i ngjashëm për viset tjera urbane (përfshirë të vetëm është Moldavia).

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

në Azerbajxhan, Moldavi, Rumani, Rusi dhe Ukrainë më pak se gjysma e ekonomive familjare në zonat rurale janë të kyçura në sistemin e ujës-jellës dhe mund të balancohen me furnizime të paqëndrueshme me ujë apo me cilësi të dobët të ujit të furnizuar.¹⁶ Çështjet e qasjes së zonave rurale në ujë të pijes dhe energji elektrike janë edhe më serioze në Azinë qendrore.

Çmimet e ushqimit rrisin dallimet në mes të zonave urbane dhe rurale

Edhe pse komunitetet urbane kanë përfituar në mënyrë disproporcionale nga rimëkëmbja ekonomike e rajonit, rritja e shpejtë e çmimeve të produkteve ushqimore kohëve të fundit është duke goditur ekonomitë familjare në zonat urbane (e veçanërisht të varfrit në këto zona) më tepër sesa ato në zonat rurale. Për dallim të varfërve në zonat rurale, pothuajse të gjitha ekonomitë familjare të varfra në zonat urbane janë neto konsumues të produkteve ushqimore. Dhe përderisa në shtetet e reja anëtare të BE-së, shpenzimet për ushqim janë të kufizuara në 20–25 për qind të shportës konsumuese të ekonomisë familjare, kjo përqindje rritet deri në 70 për qind në Azerbajxhan, Armeni, Shqipëri dhe Tashkistan.¹⁷ Në këto vende, rritja e çmimit të ushqimit do të mund të shtynte familjet e varfra në krizë edhe më të thellë. Për kontrast, ekonomitë familjare në zonat rurale mund t'ia dalin më lehtë nga kjo krizë, meqë ata përfitojnë nga rrjeti i sigurisë i mundësuar nga bujqësia si mjet jetese. Për më tepër, të paktën disa ekonomi të varfra familjare në zonat rurale janë vetëm prodhues ushqimi dhe si të tillë ata mund të përfitojnë nga çmimet më të shtrenjta. Argumenti do të mund të ishte siç vijon:

Në parim, çmimi më i lartë i ushqimit/prodhimeve bujqësore do të duhej të stimulojë zhvillimin e bujqësisë, rritjen e kërkesës për fuqi punëtore në ferma dhe të zvogëlojë varfërinë në zonat rurale. Kjo duket veçanërisht e mundshme për vendet e CIS-it me të ardhura mesatare, ku bujqësia në shkallë të madhe e cila është relativisht intensive për nga kapitali, e bazuar në fuqinë e punësuar punëtore mbetet e rëndësishme, dhe ku tregjet për prodhimet bujqësore e edhe për lëndën e parë janë relativisht konkurruese.¹⁸ Për dallim, në vendet e CIS-it me të ardhura të

ulëta (sikurse është Uzbekistani) shumë ekonomi familjare shesin prodhimet e tyre bujqësore (p.sh. pambukun) shtetit me çmime të cilat janë shumë më të ulëta sesa çmimet e tregut përderisa u duhet të blejnë lëndën e parë nga mono-polet shtetërore, në këto raste pjesë të vogla të përfitimit “sipas këtyre kushteve të tregtisë” arrijnë tek familjet e varfra në zonat rurale. Për më tepër, përfitimet e qëndrueshme përgjatë një periudhe afatgjate po aшту varen nga aftësia e fermës shtëpiake për të financuar komercializimin bujqësor (qasja në kredi ka gjasë të lehtësohet nga vlera më e lartë e tokës), në mënyrë që të rrisë nivelin e produktivitetit. Sidoqoftë, edhe në vendet më të pasura të rajonit (përfshirë edhe vendet e reja anëtare të BE-së), barrierat strukturore ndaj zhvillimit rural (p.sh. qasja joadekuate në tokë, kredi dhe tregje; struktura joadekuate fizike) mund t'i mund të bëjë që këto përfitime të mos shpërndahen në mënyrë të gjerë në mesin e komuniteteve rurale. Një infrastrukturë më e mirë, ngjashëm mund të jetë e nevojshme për të siguruar që profiti nga toka e punuar i cili mbledhet nga çmimet më të larta investohet në zonat rurale, për të shtuar produktivitetin bujqësor dhe të ardhurat.¹⁹ Një transport më i zhvilluar, ujitja dhe infrastruktura financiare në zonat rurale do të shtonte prodhimin dhe në përgjithësi të ardhurat nga ferma, do t'u ndihmonte fermerëve të vegjël të dërgojnë prodhimet e tyre në treg dhe do të shtonte kërkesën për (dhe pagat) fuqi punëtore në sektorin e bujqësisë.

Në mesin e ekonomive familjare në zonat rurale, pasojat negative të inflacionit të çmimeve të ushqimit duket se ka mundësi të jenë më të ashpra ndaj punëtorëve bujqësor të cilët nuk kanë në pronësi të tyre tokë, të cilët janë më të rrezikuarit të bëhen tepërcë nga komercializimi dhe shtimi i produktivitetit i cili rezulton nga çmimet më të larta të ushqimit. Mbrojtjet sociale të cilat janë planifikuar dhe mundësitë alternative joadekuate vetëm sa thellojnë këto probleme.²⁰ Dhe përderisa aftësia e punimit të tokës si mjet jetese për ekonomitë familjare për të ushqyer veten mund të mos ndikohet drejtpërdrejtë nga inflacioni i çmimeve të ushqimit, çmimi më i lartë i artikujve joushqimor do t'i zvogëlojë edhe më tej të ardhurat e tyre dhe do t'i bëjë që sfida e tejkalimit të varfërisë të jetë edhe më e vështirë.

¹⁶ Në vitin 2003, mesatarisht një ekonomi familjare në Tashkistan është furnizuar me ujë më pak se gjashtë orë në ditë, ndërsa në viset rurale edhe më pak. Shih: Banka Botërore (2005), op.cit., f.3.

¹⁷ Departamenti i Bujqësisë i Shteteve të Bashkuara. (<http://www.ers.usda.gov/Data/InternationalFoodDemand/StandardReports/Foodbudgetshares.xls>, July 2008).

¹⁸ Banka Botërore (2008), *Inovacion, përfshirje dhe integrim – Nga tranzicioni në konvergencë në Evropën lindore dhe ish Bashkimin Sovjetik*, f. 47-51.

¹⁹ FAO (2008), *Rritja e kërkesës për bujqësi dhe ngritja e çmimeve të produkteve ushqimore. Një mundësi për fermerat e vogla me pak të hyra, në vendet e bazuara në bujqësi?* f. 13.

²⁰ Banka Botërore (2008), op.cit f.48.

Konkluzion

Rritja e çmimeve të ushqimit do të mund të transformonte dallimet urbane – rurale në rajon duke shtyrë grupet e rrezikuara urbane edhe më thellë në varfëri dhe në të njëjtën kohë duke iu dhënë prodhuesve rural të ushqimit një mundësi për ta tejkaluar atë. Nëse do të bien nivelet e përgjithshme të varfërisë, varet nga ajo nëse ekonomitë rurale mund të kontrollojnë këto para shtesë që kanë ardhur drejt rritjes së qëndrueshme të prodhimit dhe të ardhurave nga fermat e tyre, duke krijuar kështu kërkesë të re për, dhe mundësi të reja punësimi në, shërbimet rurale dhe aktivitetet industriale. Për këtë arsye duhet të mbesin prioritetet investimet e konsiderueshme publike dhe private dhe zgjerimi i programimit të aktiviteteve rurale, në mënyrë që të përmirësohet infrastruktura fizike dhe komerciale në zonat rurale. Përndryshe, nga paratë shtesë nga rritja e çmimit të ushqimit nuk do të përfitojnë të varfrit në zonat rurale, të cilët më së shumti kanë nevojë për to.

Susanne Milcher është eksperte për Përfshirje Sociale dhe Zvogëlim të Varfërisë në zyrën rajonale të UNDP-së në Bratislavë. **Kitti Kiss** është duke ndjekur diplomën në Studimet Ndërkombëtare me specializim në politikën zhvillimore rajonale në Universitetin Eötvös Loránd në Budapest.

A po vdes fshati?

Andrew Cartwright

Ndryshimet në vendet rurale të Evropës qendrore dhe lindore shpesh paraqiten përmes tkurrjes së fshatrave në zhdukje fati i të cilave është në kontrast me dinamikën e qytetit. Ngjashëm, edhe pse preferohet dallimi mes migrimeve ndërkombëtare me atyre të brendshme si dhe mes migrimeve të përhershme dhe atyre qarkore, migrimet rurale shpesh paraqiten si humbje përfundimtare. Migrimet nga fshatrat pas vetes lënë të pensionuarit, ata në pensione mjekësore, të tillët jeta e të cilëve është punimi i tokës pronë e shtëpisë së tyre, si dhe ata që kanë ndërprerë shkollimin pas mbarimit të shkollimit fillor. Është një mbresë e përgjithshme se largimi për shkak të arsimit ose punës është arsyeja primare si hap përfundimtar i marrë nga personat në moshë të re të cilët ua kthejnë shpinën fshatit.

Kjo fotografi padyshim se është tejet e vërtetë në disa rajone. Në Shqipërinë e Jugut, për shembull, ekzodi rural ishte tejet i thellë: në disa fshatra më tepër se gjysma

e populates është mbi 60-vjeç. Fëmijët e tyre punojnë në Selanik apo Toskanë dhe nuk pritet kthimi i shpejtë i tyre; ata më parë se sa në gjuhën e tyre amtare do dëshironin arsimimin e fëmijëve të tyre në gjuhën greke apo italiane. Në raste më të shpeshta, ata të cilët megjithatë vendosin të kthehen i shfrytëzojnë kursimet e tyre për t'u zhvendosur në rajonet tjera urbane ose bregdetare ku mundësitë për turizëm apo ndërtim janë më të mëdha. Për rajonet e tilla, migrimet e jashtme janë humbje të kompenzuara pjesërisht me paratë e dërguara.

Në politikat e zhvillimit rural që udhëzojnë menaxhimin e fondeve strukturore të BE-së për vitet 2007-13, neutralizimi i migrimeve të jashtme rurale paraqitet si prioritet. Qasja Rumune ndaj këtij 'rreziku shqetësues' është të krijojnë 'kushte të domosdoshme për mënjanimin e problemeve të rënda njerëzore dhe sociale të cilat rezultojnë me migrimet e popullatës nga zonat rurale në zona urbane'. Në Hungari planifikuesit pranojnë se 'shpopullimi i vendbanimeve të vogla është një rrezik real'; derisa në Bullgari, ku janë parë disa nga migrimet më të mëdha rurale, ngritja e sektorit rural jobujqësor zhvillohet për t'i ngadalsuar migrimet e jashtme nga zonat rurale.

Ky punim do të argumentojë se fjalët mbi zhdukjen e fshatit mund të jenë e ekzagjeruara dhe atë duke shikuar nga këto tri aspekte. E para, në botimin e fundit të *Perspektivës botërore të urbanizimit (World Urbanization Prospects)*²¹ shihet se në shumicën e vendeve të Evropës qendrore dhe lindore fillimi i tranzicionit të viteve 1990 ka ndërprerë përpjekjet e mëhershme për urbanizim. Së dyti, argumenti se migrimet e jashtme nga fshatrat janë një humbje e përhershme për fshatin - nuk i përmendin kthimet e fshatarëve, pastaj natyrën shpesh të përkohshme të këtyre migrimeve të jashtme, si dhe qarkullimin e parave, të kujdesit dhe interesimit që akoma mund t'i lidhin familjarët, shokët dhe fqinjët. E treta, retorika mbi vdekjen dhe pleqërinë mund të ngatërrojë natyrën e lidhjeve fshat-qytet, në dy drejtime – se të kthyerit sjellin rigjallërimin e stilit gravitues (vajtje-ardhje) të jetesës dhe se në fakt shumë banorë qytetesh akoma mbajnë lidhje të forta me zonat rurale.

A është duke vazhduar emigrimi jashtë vendit nga zonat rurale?

Tabela e mëposhtme tregon se si, në shumicën e vendeve, tranzicioni ka ngadalësuar, ndaluar plotësisht apo ka kthyer mbrapshtë sistemet e epokës socialiste të zhvendosjeve fshat-qytet – i cili në disa vende kishte karakter detyrues. Në Rumani, e cila kishte përjetuar programe shpopulluese ndoshta ndër më të vrazhdat e kohës para-tranzicionale,

²¹ Sektori i Kombeve të Bashkuara për Popullsi, Baza e të dhënave për popullsi e rishikuar për vitin 2007 në <http://esa.un.org/unup/>.

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

popullata urbane mes viteve 1950-1990 ishte trefishuar në numër. Megjithatë, secilin vit më vonë numri i tyre ishte në zbritje. Në ditët e sotme, popullata urbane ka pësuar zbritje për 700.000, në 11.6 milionë. Popullata rurale ka përjetuar ulje gjithashtu duke rënë nga 10.8 milionë sa kishte në vitin 1990 në 10 milionë në vitin 2005, gjithmonë me rënie të mëtejshme për gjysmë milioni deri në vitin 2020.

Pjesëmarrja e Popullatës në Zonat Rurale

Shteti	1970	1980	1990	2000	2010
Bellorusia	56	43.5	34	30.1	25.7
Bullgaria	47.7	37.9	33.6	31.1	28.3
Çekia	35.6	24.8	24.8	26	26.5
Hungaria	39.9	35.8	34.2	35.4	31.7
Moldavia	67.9	59.6	53.2	55.4	58.8
Polonia	47.9	41.9	38.7	38.3	38.8
Rumania	59.7	53.9	46.8	46.5	45.4
Federata Ruse	37.5	30.2	26.6	26.7	27.2
Sillovakia	58.9	48.4	43.5	43.7	43.2
Ukraina	45.2	38.3	33.2	32.9	31.9

Burimi: Perspektiva botërore e urbanizimit (World Urbanisation Prospects), 2007. (<http://esa.un.org/unup/>).

Shpesh diskutohet se zonat rurale kanë qenë zbutës që kanë absorbuar tronditjet e viteve 1990. Për ata që humbën vendet e punës në zonat urbane apo për ata për të cilët jetesa në këto zona ishte e shtrenjtë, dekollektivizimi krijoi mundësi për t'i rikthyer apo blerë tokat bujqësore dhe si duket përkohësisht t'i kthehen jetës së fshatit përmes një bujqësie pjesërisht për nevoja vetanake. Ky pra ishte një shteg i shkelur mirë për ata të moshës mbi 40 apo 50-vjeç të cilët dolën në pension të parakohshëm apo në pensione të sëmundjes. Shembulli i Hungarisë: regjistrimi i fundit bujqësor tregonte mbi 960.000 toka bujqësore në madhësi prej më pak se një hektarësh në pronësi të ekonomive familjare, që prodhonin ushqime kryesisht për konsumim familjar. Strategjia e fundit e Hungarisë për zhvillim rural shënon se moshë mesatare për bujqit individualë është 60 për ferma dhe 53 për meshkuj; dhe se, derisa në vitin 1996, 21.8 përqind e të punësuarve në bujqësi ishte nën moshën 30-vjeç, kjo pjesëmarrje është zvogëluar në 15.2 përqind. Urbanizimi mund të ketë ngadalsuar por gjithashtu përcillet me demografinë 'e pafavorshme' rurale.

A është emigrimi rural edhe aq i keq?

Përshtypja se popullata rurale është më pak e gatshme për emigrime sesa popullata urbane qëndron e fortë. Studimi i Dumitru Sandu²² në Rumani, ku 2-4 milionë njerëz mendohet se punojnë jashtë vendit, mbi emigrimet nga fshati, ka zbuluar se më pak se 200.000 njerëz punonin jashtë vendit gjatë periudhës së studimit të tij të vitit 2001. Sandu gjithashtu gjeti se shumë emigrantë mund të cilësoheshin si emigrantë përsëritës apo emigrantë qarkullues, për të cilët puna jashtë vendit ishte bërë mënyrë jetese. Për më tepër, ishte e mundur të identifikoheshin një numër karakteristikash të fshatrave që mund të rrisnin mundësitë për kthim të atyre që kanë lëshuar vendin – qëndrimi në rajone relativisht më të varfëra, afërsia me ndonjë qytet tregtar, afërsia me autostradë, mbizotërimi i popullatës më të re, si dhe me një traditë të ndërrimit me disa nga të papunësuarit më të vjetër. Këso tiparësh janë gjetur në 4 përqind të fshatrave që llogarisnin rreth 60 përqind të emigrantëve qarkullues nga fshatrat. Si shembull, afër disa qyteteve më të vogla të Rumanisë është e zakonshme të shihen fshatra që shkrihen drejt kufirit të qyteteve, duke zhdukur vijën mes qytetit dhe fshatit. Këto zhvillime para-urbane mund të financohen me paratë e dërguara nga jashtë.

Emigrantët nga zonat rurale që jetojnë në qytetet e Evropës qendrore dhe lindore zakonisht kanë lidhje më të forta me rajonet rurale sesa që është rasti me pjesët tjera të Evropës. Këto lidhje mund të kenë marrë formën e vizitave shtëpiake, hobive me punë vikendi në bujqësi, prodhimin e birrës shtëpiake, dhe të ngjajshme. Andre Czegléd²³ i referohet 'fshatarëve urbanë' të cilët parapëlqejnë kohën me familje e që përcillet me përgatitje ushqimesh nga vetë ata. Këta nuk janë vizitorë një ditorë vikendi që marrin rrugë për në fshatra në vende tjera të Evropës: këta zakonisht vizitojnë familjarët, kushërinjtë më të vjetër që kanë mbetur apo pensionuar dhe kthyer në vend. Këso lidhesh janë një linjë jetësore për fshatrat, duke sjellur njerëz të rinj, fonde për përmirësim, barëra, shoqëri, lajme ose shoqërime – luftim i ndjenjave të izolimit apo largësisë. Edhe pse lidhje të tilla fshat-qytet janë prezente në shumë vende të rajonit, ato nuk janë të pasqyruara mirë në projektet e zhvillimit rural në BE-së. Një vëmendje i është dhënë bujqve pjesërisht të vetmbajtur me një theks në nxitjen e atyre që mund të tregojnë më shumë prodhimet e tyre. Megjithatë, shumica e fshatarëve urbanë nuk duket se janë të përfshirë në planifikime të tilla.

²² Dumitru Sandu, 'Migrimet transnacionale nga fshatrat e Rumanisë', *Migration online, Focus on Central and Eastern Europe*, 2002. www.migrationonline.cz/studies_f.shtml?x=195089

²³ Andre Czegléd, 'Fshatarët urbanë në botën post-socialiste. Bujqit e vegjël në Hungary', në Pamela Leonard dhe Deema Kanef (eds.) *Fshatari-Qytetari post-socialist dhe ndërtimi urban i identifikimit në Evropën lindore, Azinë lindore, dhe ish-Bashkimin Sovjetik*, Palgrave (Hampshire: England), 2002.

Është e qartë se shumë nga zonat rurale nuk mund të mbajnë popullatën e tyre në vend për shkak të mungesës së mundësive nëpër fshatra. Mirëpo, pse të mos konsiderohen masat për rritjen e lëvizjeve, mbështetjen e lëvizjes dhe e kundërta, forcimin e lidhjeve fshat-qytet? Kjo do të thotë, kujdes më i madh për lidhjet rrugore rurale dhe të transportit, furnizimet me rrymë, mbulimi me rrjet të TI-së dhe infrastrukturë tjetër për të nxitur mundësitë e punësimit në periferi të qyteteve. Së dyti, aty ku punëtorët kërkojnë mundësi jashtë vendit, një shteg do të ishte në tërheqjen e të kthyerve të mundshëm derisa akoma janë jashtë vendit duke fituar para. Sindikata spanjolle e bujqësisë në Andaluzi ofron një shembull të tillë: duke pranuar se shumë nga punëtorët bujqësorë nga Rumania janë tejet të kualifikuar për të zgjedhur punë andaj Sindikata u ofron mbështetje në planifikim afarist në etapa të hershme të kthimit të tyre në Rumani. Kjo ide do të zgjeronte audiencën e caktuar për planifikuesit e politikave përtej atyre të cilët aktualisht jetojnë në fshatra me ata të cilët do të mund të ktheheshin së shpejti.

Andrew Cartwright është Bashkëpunëtor kërkimor në Qendrën për studime të politikave, Universiteti i Evropës qendrore.

Çmimet në rritje të produkteve ushqimore dhe mundësitë për rritjen e prodhimit bujqësor

Nick Maddock dhe Levent Koro

Efektet e mundshme afatshkurtra të ngritjes së çmimeve të produkteve ushqimore janë shqyrtuar gjer e gjerë, ku qartazi shihen ndikime negative në kuptim të rritjes së varfërisë, posaçërisht për të varfrit që jetojnë në zona urbane, të cilët kryesisht janë konsumatorët kryesorë të këtyre produkteve. Prej marsit 2007, çmimet e produkteve ushqimore në Kosovë janë ngritur për 25% në vit, dhe pasi që produktet ushqimore përfaqësojnë rreth 42 % të shpenzimeve të konsumatorëve në Kosovë, rënia në të hyrat reale ka qenë e dukshme. Kjo në veçanti ka implikime serioze tek familjet që jetojnë rreth vijës së varfërisë absolute dhe kërcënon të rrisë nivelet tanimë të larta të varfërisë në Kosovë.

Analizat e ngritjeve të fundit të çmimeve identifikojnë një numër shkaqesh, duke përfshirë kërkesën në rritje nga Kina dhe India, si dhe prodhimin e biokarburanteve në perëndim. Thatësira në disa vende kryesore furnizuese (siç është Australia) mund gjithashtu t'i kontribuojë kësaj

gjendjeje. Edhe pse nivelet e tanishme të çmimeve nuk mund të përfaqësojnë çmimet afatgjata, duket se në përgjithësi çmimet më të larta të produkteve ushqimore do të mbesin të tilla.

Mbrojtja e të varfërve urbanë nga pasojat e çmimeve më të larta është një sfidë e politikave shoqërore, e cila ka të bëjë me aftësinë e qeverisë që të fokusojë ndihmesën sociale për ata që u nevojitet më së shumti. Por këtu ka gjasa që të ketë edhe fitues, ku rritja e çmimeve do të mund të krijonte përfitime të mundshme afatmesme dhe afatgjata si makroekonomike, ashtu edhe mikroekonomike për bujqësinë dhe për ekonominë rurale në përgjithësi. Pasi që dy të tretat e të varfërve në Kosovë jetojnë në vendet rurale, çmimet më të larta krijojnë potencial që të zbriten nivelet e varfërisë në mënyrë të dukshme.

Edhe me metodat ekzistuese të kultivimit të drithërave dhe ato agronomike, çmimet e rritura do të krijojnë kthime më të mëdha të investimeve në tokë, me kusht që natyrisht nga çmimet më të larta të përfitojnë bujqit. Kjo do të kontribuon në zhvillimin e bujqësisë dhe në zvogëlimin e varfërisë pa ndonjë veprim nga ana e prodhuesve. Për më tepër, përfituesit nga çmimet në rritje të produkteve ushqimore nuk do të jenë vetëm bujqit dhe kultivuesit, por edhe argatët ruralë, pasi që zhvillimi i bujqësisë ka gjasë të rrisë kërkesën për fuqi punëtore. Por shkalla e përfitimit të bujqve nga çmimet në rritje të produkteve ushqimore varet edhe nëse ata mund dhe do të përgjigjen në çmimet më të larta me rritjen e prodhimit të tyre. Më tej, nëse prodhimi shtesë vjen nga bujqit më të mëdhenj, atëherë ndikimi i varfërisë do të jetë minimal. Në fakt, zvogëlimi më i madh i varfërisë do të jetë i mundshëm në Kosovë vetëm nëse bujqit e vegjël (që kryesisht janë bujq të subvencionuar) gjithashtu reagojnë me ngritje të furnizimit.

Ekziston një numër mënyrash për rritjen e prodhimit bujqësor. Njëra nga to është rritja e sipërfaqeve të mbjella. Kjo natyrisht varet nga disponueshmëria me tokë, ku në praktikë vërehet se Kosova ka toka të pashfrytëzuara bujqësore. Vendimi për shfrytëzimin e tokave të pashfrytëzuara varet nga shkalla e kthimit (në bujqësi, e shprehur në kuptim të fitimit nga shitja) që ndikohen drejtpërsëdrejti nga kostoja e prodhimit, e farës, e plehrave, e pesticideve, e ujitjes dhe nga kostoja e qirasë. Mirëpo, në mungesë të shërbimeve këshillimore për ferma, bujqit kanë një bazë të kufizuar për të përcaktuar metodat agronomike dhe fitimet e mundshme nga shitja.

Në praktikë çmimet më të larta të produkteve ushqimore ofrojnë përfitime më të mëdha të kapitalit të punës dhe mënyrë për financimin e blerjes së repromaterialit. Kjo është e rëndësishme pasi që kapitali i punës shpesh është

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

faktor kufizues, ku pjesë të mëdha të sektorit bujqësor kanë kaluar në prodhimin pa repromaterial apo me repromateriale të lira. Por, nga ana tjerët çmimet në rritje do të mund t'i rrisnin përfitimet në kapitalin e punës dhe t'u ofrojnë bujqve stimulime dhe financime për përdorimin e repromaterialeve të blera dhe rrjedhimisht t'u mundëson atyre të përfitojnë në rendimente dhe në autpute. Më tej, kombinimi i kësaj me aktivitete më të theksuara nga kooperativat bujqësore ofron perspektivën që bujqit të kenë marrëveshje më të mira rreth çmimeve të repromaterialit dhe të autputeve, duke i rritur kështu edhe fitimet.

Fitimet më të larta që vijnë nga rritja e çmimeve janë në fakt fitime të papritura nga bujqit, të cilat në afat të mesëm dhe të gjatë mund të çojnë në konkurrencë më të madhe për tokë bujqësore. Kjo nga ana tjetër mund të rrisë çmimet e tokave bujqësore (në varshmeri, natyrisht nga tregjet e tokës së punueshme) dhe, në këto rrethana, bujqit me siguri do të kërkojnë fitime më të larta nga vlera e kapitalit të pronave të tyre të tokave. Efekt i kësaj mund të jetë inkurajimi i bujqve që të investojnë në fermat e tyre, duke kërkuar kështu kthime më të larta të kapitalit të investuar. Investimet më çmimet më të larta të autputeve mund të bëhen të mundshme financiarisht dhe, për shkak të fitimeve në përgjithësi të përmirësuar të tanishme dhe të atyre të pritshme, bujqit mund të bëhen gjithnjë më të aftë për financimin e tyre. Këto investime mund të bëhen në fusha të ndryshme, duke përfshirë sistemet e ujitjes dhe serrat. Këto të fundit do të kishin për qëllim furnizimin e tregjeve jashtë sezonit, ku çmimet janë më të larta. Në vendet në tranzicion, tregjet e tilla shpesh janë të furnizuara tepër nga importet, zakonisht për shkak të faktit se mbulimi i sipërfaqeve me serra është i vogël dhe/apo se depot janë të kufizuara apo joefikase.

Mënyra tjetër e rritjes së prodhimit është përmes rendimenteve më të larta. Njëra nga mënyrat e dukshme është përmes rehabilitimit të sistemeve të ujitjes dhe të rritjes së sipërfaqeve të ujitura. Sistemet e ujitjes mbesin një e mirë gjysmëpublike, me kanale primare dhe sekondare në pronësi publike dhe me ato terciare në pronësi private. Përparimi në rehabilitimin aq shumë të nevojshëm ka qenë tepër i ngadaltë dhe sipërfaqet e ujitura kanë shënuar rritje të vogël, ku deri në rritjen e fundit të çmimeve, fizibiliteti financiar dhe ekonomik për rehabilitimet e mëdha dhe për skema të reja nuk ka qenë tërheqës. Rritjet e çmimeve duhet ta ndryshojnë këtë në mënyrë domethënëse dhe mund të inkurajojnë si shpenzimet publike, ashtu edhe ato private në sisteme të ujitjes. Bujqit potencialisht do të jenë më të aftë për të paguar çmimet e ujit, ndërsa qeveritë do të duhej të ishin në gjendje të financojnë investimet publike në ujitje (duke supozuar ekzistimin e rregullimeve të volitshme tatimore dhe të pagesës së ujit).

Përdorimi i varieteteve të përmirësuar është mënyrë tjetër për të ecur përpara. Bujqësia me nivel të ulët të repromaterialit apo pa të fare shpesh do të thotë se prodhohen varietete homogjene lokale. Edhe në rastet ku shfrytëzohen repromaterialet e blera (kryesisht në ferma më të mëdha) shpesh ka mungesë të informatave për mundësit e prodhimit dhe të tregut që ndërlidhen me varietetet e reja. Këto varietete mund të ofrojnë kthime më të mira të investimeve përmes rendimenteve më të larta, çmimeve më të larta, cilësisë më të mirë, pozicionimeve të tregut apo mundësive të eksportit. Duke supozuar se rritja në çmimet e autputit e kalon rritjen e shpenzimeve të repromaterialit, pastaj rritja e çmimeve të autputeve dhe rritja e fitimeve u ofrojnë bujqve stimulime dhe fonde për të financuar kapitalin në varietete më të mira.

Lehtësimi i ndryshimeve të varieteteve dhe kultivimi i përmirësuar i drithërave zakonisht është përgjegjësi e shërbimeve aftësuese dhe e institucioneve për hulumtime bujqësore. Në praktikë, shërbimet aftësuese dhe hulumtimet bujqësore në shumicën e vendeve në tranzicion janë në një mosharmoni, dhe në shumicën prej tyre, njëra apo tjetra ka rënë në kolaps. Shërbimet e aftësimit janë dhënë në kuadër të shërbimeve të integruara në strukturën kolektive të fermave dhe janë shkatërruar me dekollektivizimin. Ato shërbime që kanë mbetur kanë tendencë t'i shërbejnë vetëm fermat më të mëdha, ku përpjekjet për futjen e gjeneratës së re të shërbimeve të aftësimit kanë shënuar rezultate zhgënjyese, ku disa syresh tanimë kanë rënë në kolaps (siç është për shembull rasti i Bosnjës dhe Hercegovinës). Hulumtimet bujqësore ende ekzistojnë në disa vende (kryesisht në kuadër të universiteteve bujqësore dhe të instituteve hulumtuese), por dhënia e shërbimeve është e parregullt me lidhje dhe qasje në hulumtimet ndërkombëtare bujqësore shpesh të dobëta.

Është po ashtu e mundshme që rritjet e çmimeve të kenë efekte dytësore, kryesisht në ndryshimet strukturore në bujqësi. Tranzicioni tanimë është ndërlidhur me ndryshimet e mëdha strukturore. Kjo është e dokumentuar mirë dhe ka pasur bujë më të madhe në ato vende ku bujqësia është kolektivizuar dhe ku tokat kanë qenë apo janë në proces të kthimit në pronësi private.

Vendet që i janë bashkuar BE-së në vitin 2004 dhe 2007 e transferuan një pjesë të madhe të tokave të tyre bujqësore në pronësi private dhe kanë kërkuar përfundimin e ristrukturimit përmes tregut të tokave. Në kundërshtim me këtë, ristrukturimi bujqësor jashtë kufijve të tanishëm apo të mundshëm të BE-së është ndalur apo është shumë i ngadalshëm. Kjo nganjëherë ndodh për shkak të arsyeve politike (siç është rasti në Ukrainë), por po ashtu mund të jetë për shkak se bujqësia është parë si sektor në depre-

sion dhe që nga atëherë ka pasur presion të vogël për të arritur strukturën e pronësisë së tokave që inkurajon bujqësi të qëndrueshme. Rrjedhimisht, kthimi i tokave, vënia në regjistrat kadastralë dhe emërtimi i tyre mbesin të pakryera, tregjet e tokave funksionojnë dobët apo fare nuk funksionojnë. Është me rëndësi të ceket se tokat bujqësore nuk mund të merren si peng, duke kufizuar kështu dhënien e financime afatgjata për bujqësi

Ngritjet e çmimeve të drithërave mund të ndihmojnë në ndryshimin e kësaj, duke e bërë kështu bujqësinë tërheqëse. Nëse vërehen mundësi për kthime më të mira të investimeve, pronarët e tanishëm apo të mundshëm të tokave mund të ushtrojë presion të rritur për zgjidhjen e kërkesave pronësore në toka bujqësore, siç janë që ata të mund ta shesin, ta punojnë apo që t'i rrisin pronat e tyre në sipërfaqe të qëndrueshme përmes blerjes së tokave. Gjithashtu do të ketë stimulime për qeveritë për të shpejtuar ristrukturimin nëse mundësitë për përfitime nga eksporti i ushqimit rriten dukshëm (apo nëse zëvendësimi i importit bëhet më tërheqës) dhe po ashtu nëse tatimet në tokat bujqësore, aty ku ato ekzistojnë, do të mund të ngriteshin nga nivelet shumë të ulëta të tanishme.

Stimulimi i industrisë së re për përpunimin e produkteve ushqimore në Kosovë

Nick Maddock dhe Levent Koro

Përkundër numrit të madh të popullsisë rurale (me rreth 60% që jetojnë në vendet rurale) dhe që merren me sektorin e bujqësisë, i cili në vitin 2005 kontribuojë me 19% në BPV dhe me 22% në punësim, tani për tani në Kosovë industria e përpunimit të produkteve bujqësore është shumë e pazhvilluar. Zhvillimi i kësaj industrie u ndërpre pas shkatërrimit të Jugosllavisë për shkak të ndërprerjeve të furnizimit me lëndë të para dhe të problemeve të hyrjes në tregje të jashtme. Përveç kësaj, siç ishte rasti edhe me sektorët e tjerë, gjatë konfliktit të armatosur të fundviteve të 1990-ta ka patur shkatërrime të mëdha të infrastrukturës fizike. Kjo e preku edhe bujqësinë duke shkaktuar dëmtime të objekteve bujqësore, të të mbjellave, si dhe të humbjes së bagëtisë dhe të mekanizimit bujqësor.

Importet e produkteve ushqimore që në vitin 2005 kapnin shumë prej 288 milionë euro, paraqesin rreth 25% të importeve të përgjithshme, ndërsa nga ana tjetër, ek-

sporti i produkteve ushqimore kapi shumë prej vetëm 7.8 milionë euro (apo 16% të eksportit të përgjithshëm). Tokat bujqësore tani për tani kryesisht përdoren për kultivimin e drithërave (62%), si dhe për kultivimin e bimëve foragjere dhe për kullosa (32%). Më pak se 1% e tokave shfrytëzohet për pemë dhe perime. Megjithatë, tokat e mbjella me pemë kanë rënë prej afro 12.000 ha, sa ishin në vitin 1980, në pothuajse 5.000 ha në vitin 2005. Ngjashëm me këtë, rënie drastike është shënuar në prodhimin e perimeve (prej 25.000 ha në vitin 1980 në 17.400 ha në vitin 2005). Kjo sugjeron për ekzistimin e mundësisë së rimëkëmbjes së këtyre nënsektoreve dhe, me siguri, për një tepricë që do të përpunohej.

Në Kosovë, aktualisht përpunimi i produkteve ushqimore është në nivel shumë të ulët dhe, rrjedhimisht, ky burim krijon shumë pak vlerë të shtuar. Pothuajse gjysma e produkteve të pemishteve shfrytëzohet në fermë, ku pjesa tjetër dërgohet në tregje të pemëve të freskëta, dhe kryesisht shitet me klasifikim minimal. Afro 75% e prodhimit vendor të perimeve dërgohet në treg, kryesisht në mënyrë joformale përmes kamionëve që i shesin ato jashtë qyteteve kryesore.

Në Kosovë ekziston vetëm një përpunues i pemëve dhe perimeve (në Prizren). Zhvillimi i ngadalshëm i mjeteve për përpunim të produkteve bujqësore ka ndikuar që pothuajse të mos ketë vende të reja të punës nga ky burim. Në vendet rurale ekziston një papunësi e lartë (ku bujqësia paraqitet si një rrjet social i sigurisë). Mirëpo, me komercializimin e bujqësisë, ekziston mundësia e shtimit të vendeve të reja të punës. Andaj, zhvillimi i industrisë së përpunimit të produkteve bujqësore do të jetë element i rëndësishëm në krijimin e vendeve të reja të punës në vendet rurale, ku, në fakt, mundësitë e tjera për gjetjen e vendeve të punës në vendet rurale janë të vogla. Kështu që, përkrahja e përpunimit të produkteve bujqësore ka gjasa të jetë prioritet.

Fabrikat për përpunimin e produkteve ushqimore janë shfrytëzuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, në Irlandë dhe në Mbretëri të Bashkuar si mënyrë për stimulimin e zhvillimit të bizneseve si në vendet rurale, ashtu edhe në ato urbane. Fabrika për përpunimin e produkteve ushqimore në thelb të saj e ka një 'kuzhinë komerciale', e cila është në dispozicion për qiradhënie afatshkurtër (zakonisht në orë). 'Kuzhina' dhe shërbimet përcjellëse që mund të merren nga shfrytëzuesit ua mundësojnë ndërmarrjeve të reja bujqësore dhe jobujqësore që t'ia fillojnë punën dhe me kalimin e kohës të bëhen profitabile. Procedura e zakonshme është që prodhuesi e sjell produktin e vet, e përdorë 'kuzhinën' për përpunimin e produktit ushqimor dhe pastaj produktin final e dër-

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

gon në treg. Kështu që prodhuesit përkohësisht bëhen qiramarrës të objektit, duke paguar qira për kohën që e shfrytëzojnë dhe nganjëherë edhe për vendosjen e tyre në depo, për pajisje dhe për shpenzime të tjera. Klientët paguanjë vetëm për kohën që e shfrytëzojnë objektin dhe për çfarëdo këshille tjerët të biznesit apo teknike që e kërkojnë. Pa zbatimin e kësaj procedure, bujqit e vegjël kanë pak gjasa të që t'ua shtojnë vlerën produkteve, pasi që ata nuk kanë mundësi të ndërtojnë dhe të mirëmbajnë objekte të tyre për përpunim të produkteve ushqimore.

Tani për tani në vendet në tranzicion nuk ekzistojnë fabrika për mikropërpunim, përkundër faktit se bujqit dhe përpunuesit e tjerët të mundshëm të produkteve ushqimore po ballafaqohen me sfida të njëjta në fillimin dhe rritjen e bizneseve për përpunimin e ushqimit. Ata ballafaqohen me vështirësi të mëdha në marrjen e kredive dhe, përveç kësaj, qasja në treg është e kufizuar nga kërkesat e vetëshërbimeve të mëdha për sasi minimale dhe për regjistrim të TVSH-së, si dhe nga kufizimet në qasje në treg për shkak të zhvillimit të ngadalshëm të shitjes me shumicë dhe të kooperativave.

Fabrikat për mikropërpunimin e produkteve ushqimore u japin mundësi prodhuesve në Kosovë, duke ua mundësuar bujqve që t'ia shtojnë vlerën produkteve përmes përpunimit të produkteve ushqimore me një kosto shumë më të vogël se sa që do t'u kushtonte që të kenë 'kuzhinën' e vet komerciale. Ata po ashtu do të inkurajonin zhvillimin profesional të ndërmarrësve dhe të bizneseve të reja në fushën e produkteve ushqimore, dhe do të përkrahnin bizneset ekzistuese në sektorin e prodhimit të produkteve ushqimore.

'Kuzhinat' gjithashtu mundësojnë përpunimin e pemëve dhe perimeve, ku prodhuesit përzgjedhin se çka të përpunojnë dhe vendosin për produktin përfundimtar. Ato gjithashtu janë bazë për themelimin e kompanive për përpunimin e produkteve ushqimore, të cilat gradualisht rriten. Megjithatë, shfrytëzuesit prapë do të jenë në gjendje të përdorin këto 'kuzhina' në mënyrë që të fitojnë një përvojë në biznes, para se të kërkojnë kredi për të, financuar 'kuzhinat' e veta për përpunim të produkteve ushqimore.

Shfrytëzuesit mund të jenë prodhues të lëndëve të para (gjegjësisht, vet bujqit); përpunuesit që dëshirojnë të provojnë prodhimin, duke përdorur produktet e blera dhe lëndët e tjera të para; përpunuesit ekzistues të vegjël që kërkojnë rritjen e kapaciteteve, pajisje më të mira apo pajisje që nuk i kanë; si dhe sektori i restoranteve dhe i hoteleve. Përveç kësaj, një fabrikë për mikropërpunimin e produkteve ushqimore që do të ishte afër ndonjë qendre

për aftësim profesional apo të trajnimit do të mundësonte aftësimet për teknologjinë e përpunimit të produkteve ushqimore dhe atë të pastërtisë së ushqimit, duke ofruar një objekt ku të gjitha këto do të demonstroheshin në mënyrë praktike.

Shfrytëzuesit i bëjnë produktet sipas recetave të veta pa ndonjë ndërhyrje nga jashtë në produkt final apo kontroll të cilësisë së tij. Këtu bën përjashtim pastërtia e ushqimit. Zakonisht, ata që për herë të parë e përdorin 'kuzhinën' e vijnë në një kurs të shkurtër të aftësimit në pastërtinë e ushqimit, ku bëhen kontrolle të vendit gjatë prodhimit për ta siguruar respektimin e procedurave themelore për pastërtinë e ushqimit. Ky aftësim zakonisht bëhet falas për shfrytëzuesit.

Produktet kryesore të prodhuara në këtë lloj fabrike do të ishin reçelet dhe marmelatat, turshitë, pemët dhe perimet e terura, lëngjet dhe erëzat tradicionale. Më vonë, shpresohet se shfrytëzuesit do të diversifikojnë asortimentin e tyre, duke përfshirë me siguri edhe erëza, sheqerka, torte dhe biskota, bukë speciale, si dhe ushqimin e djegës dhe meze të lehta (kikirikë, smoki, çipsa, shkopinj të njelmët). Megjithatë, zgjidhja për llojin e prodhimit do të varet plotësisht nga shfrytëzuesit.

Në mënyrë që biznesi i tyre të zhvillohet, shfrytëzuesit kanë nevojë për këshilla të biznesit. Shpeshherë, shërbimet këshillimore të biznesit mund të gjenden në këto fabrika. Shfrytëzuesit mund të marrin një vështrim të tërë të shërbimeve me pagesë, duke përfshirë regjistrimin e biznesit, mbajtjen e librave, regjistrimin dhe deklarimin e tatimeve, përgatitjen e kontratave, këshilla juridike, dizajnin dhe reklamimin, shtypjen dhe llojet e tjera të shërbimeve të marketingut. Po ashtu, shfrytëzuesit mund të blejnë me çmime më të lira të shumicës inputet themelore, lëndën e parë dhe furnizimet e tjera (duke përfshirë kavanozat dhe kanaçet).

Marketingu mund të jetë sfida e madhe për industrinë e reja të përpunimit të produkteve ushqimore. Kështu që, përderisa shfrytëzuesit do të merrnin përgjegjësinë për reklamimin e produkteve të veta, gjithashtu do të ofrohej ndihmesa edhe në këtë drejtim. Këtu do të mund të përfshiheshin qendrat shpërndarëse të produkteve në vendin ku ndodhet 'kuzhina kooperative' apo diku tjetër në Kosovë, ku produktet mund të shiten nga 'kuzhina'. Promovimi mund të bëhet përmes vitrinave për produktet e prodhuara në kooperativë në tregje lokale apo mbarësh-tetërore.

Ndërtimi i një objekti të tillë do të ishte një veprim eksperimental në zhvillimin e agropërpunimit të shkallës së

ulët. Është e qartë se sektori konkurrues i agropërpunimit i bazuar në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) do të jetë, siç ishte rasti edhe në Evropën Perëndimore, një burim i inovacionit, punësimit dhe i zhvillimit rural. Por, duke marrë parasysh kufizimet mbizotëruese, një reagim i tregut me rastin e daljes në pah të sektorit të vogël të agropërpunimit në Kosovë ka pak gjasa të ndodh, andaj, nëse dëshirojmë që ky sektor të zhvillohet, do të ketë nevojë për përkrahje.

Ndikimi i kontrollit të ushqimit në zhvillimin bujqësor dhe në sigurinë e ushqimit në Kosovë

Agim Rysha

-I- Sektori i ushqimit dhe mundësitë për zhvillim bujqësor në Kosovë

Siguria e ushqimit gjithnjë e më shumë po bëhet interes strategjik i vendeve në mbarë botën. Rrjedhimisht, në shumë vende prodhimi i ushqimit të sigurt është renditur në mesin e prioriteteve zhvillimore.

Fatkeqësisht, Kosova për shkak të së kaluarës mirë të njohur të saj ende është mjaft e varur nga ushqimi që vjen nga importi. Edhe pse shumica e kosovarëve jetojnë në viset rurale, vetëm një sasi e vogël e ushqimit të konsumuar vjen nga toka e Kosovës.

Gjendja e tanishme është rezultat i shumë faktorëve, siç është mungesa e investimeve në bujqësi dhe në industrinë e përpunimit të ushqimit gjatë 20 viteve të fundit, mungesa e strategjisë shtetërore për zhvillimin e këtij sektori shumë të rëndësishëm; pastaj edhe infrastruktura e dobët në viset rurale, siç është ajo rrugore, e ujitjes; problemet me energjinë elektrike, kamatat e larta për marrjen e kredive nga bankat, etj.

Vlerësimet e ndryshme që janë bërë lidhur me mundësitë ekonomike për zhvillimin e Kosovës treguan se sektori i bujqësisë dhe ai i ushqimit mund të luajnë rol kyç në zhvillim dhe krijim të shpejtë të të ardhurave për të papunët që kryesisht jetojnë në viset rurale.

Kosova është shtet i vogël dhe me sipërfaqe të vogël të tokës për kultivim, që rrjedhimisht nënkupton se nuk ka mundësi të konkurrojë madje as në tregjet rajonale me drithëra, siç janë gruri dhe misri, por ka një potencial shumë të mirë në prodhimin dhe përpunimin e

shumë pemëve dhe perimeve, por edhe të produkteve të posaçme me origjinë shtazore.

Organizata të ndryshme donatore janë duke e drejtuar përkrahjen e tyre financiare dhe teknike drejt këtyre mundësive zhvillimore në viset rurale.

-II- Efektet pozitive në prodhimin, konsumin dhe eksportin e mundshëm të produkteve ushqimore nga Kosova drejt shteteve të BE-së

Kosova ende ka një ekonomi të dobët, dhe ka nevojë të angazhohet në përpjekje për zëvendësimin e importeve përmes prodhimit dhe konsumit të produkteve bujqësore vendore, por edhe përmes eksportit të produkteve që kërkohen në tregjet ndërkombëtare.

Disa produkte bujqësore dhe ushqimore nga sektorët, siç janë: pemëtaria, perimtaria; dhe nga bimët, siç janë ato mjekësore, frutat e malit; si dhe vera dhe produktet e peshkut e të qumështit kanë shënuar rritje të prodhimit.

Prodhuesit e këtyre produkteve kanë kuptuar sesa është i rëndësishëm prodhimi i produkteve më cilësore.

Prodhimi i produkteve bujqësore të papërpunuara dhe përpunimi i tyre final për konsum duhet të përmbush kërkesa dhe standarde të ndryshme që përcaktohen nga organet e pranuar ndërkombëtare.

Pranimi dhe zbatimi i standardeve të cilësisë dhe të sigurisë për produktet ushqimore të prodhuara në viset rurale të Kosovës do të jetë i rëndësishëm thelbësor dhe do t'u jep mundësi bujqve dhe kompanive të përpunimit të ushqimit të jenë konkurrues në treg, por edhe të përfitojnë më shumë nga prodhimet e tyre të vlefshme.

Nga aspekti gjeografik, Kosova është pjesë e Evropës, dhe objektivi i saj në të ardhmen është që të bëhet anëtare e BE-së. Kjo do të thotë se çdo gjë që ka të bëjë me bujqësinë dhe përpunimin e ushqimit duhet të jetë në përputhje me ligjet dhe rregullat e BE-së.

Në ditët e sotme, sistemi i kontrollit të ushqimit jo vetëm që parandalon rreziqet, por nëse nuk ekziston ka ndikim shumë negativ për zhvillimin e bujqësisë dhe të përpunimit të ushqimit.

-III- Parimet e përgjithshme të cilësisë së ushqimit dhe të kontrollit të sigurisë së tij

Vendet e ndryshme krijojnë sisteme të kontrollit të ushqimit në mënyra të ndryshme. Kjo do të thotë se këto sisteme mund të ndryshojnë prej vendit në vend, por në përgjithësi sistemi përbëhet prej elementëve vijues:

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

Ligjet dhe legjislacioni sekondar (Ligji për ushqimin, rregulloret e ndryshme të bazuara në parimet kornizë, etj); menaxhimi i kontrollit të ushqimit (sistemet e vetëkontrollit të zhvilluara nga industritë, duke përfshirë standartet e ndryshme ndërkombëtare për produkte ushqimore); shërbimet e inspektimit (të organizuara në të gjitha nivelet – pra në atë qendror, regjional dhe komunal); inspektimi laboratorik (përmes analizave të ndryshme të ushqimit, siç janë ato kimike, mikrobiologjike, etj); informimi, arsimi dhe aftësimi i qytetarëve (transparenca, informatat për rreziqet e mundshme. Arsimimi dhe aftësimi i atyre që merren me biznesin e produkteve ushqimore, etj)

-IV- Sistemi i tanishëm i kontrollit të ushqimit në Kosovë

Përgjegjësia për sistemin e kontrollit të ushqimit u takon dy ministrive: Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Shërbimet e inspeksionit janë po ashtu të mbikëqyrura nga nivele të ndryshme qeveritare, siç janë niveli qendror, regjional dhe ai komunal i Kosovës.

Për shkak të këtyre ndarjeve të përgjegjësive dhe të legjislacionit të copëzuar, veprimtaritë kontrollit nuk janë të bashkërenduara mirë që rezultojnë me mungesë të zbatimit të ligjit dhe me zbatim jo të duhur të tij.

Përveç zhvillimit të sistemit për vetëkontroll nga ana e industrisë, që mund të parandalojë problemet shëndetësore që ndërlidhen me ushqimin, sistemi i inspeksionit po ashtu luan rol kyç në mbrojtjen e shëndetit publik.

Sistemi i inspektimit në Kosovë zbatohet si në vijim:

Inspeksioni veterinar funksionon në nivel qendror dhe në atë komunal; inspeksioni i veterinarisë kufitare, fitosanitarisë dhe i sanitarisë është në kuadër të Agjencisë për veterinarin dhe ushqim të Kosovës, e cila është në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë.

Inspeksioni sanitar është në kuadër të Inspektoratit sanitar të Kosovës, i cili është nën Ministrinë e Shëndetësisë.

Laboratorët përgjegjës për monitorimin e cilësisë dhe sigurisë së ushqimit në Kosovë po kështu janë në kuadër të përgjegjësive të ministrive të ndryshme. Laboratori i veterinarisë dhe Instituti i bujqësisë janë në kuadër të MBPZHR (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural), ndërsa Instituti për Shëndetësi Publike (ISHP) është në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

Asnjëri nga laboratorët e përmendura nuk janë të akredituara.

-VI- Legjislacioni

Projektligji për produktet ushqimore i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës pothuajse para tri vitesh. Ky projektligj që pret miratimin nga Kuvendi i Kosovës nuk është në përputhje me kushtet e BE-së, pra edhe nëse Kuvendi e miraton ligjin, i njëjti duhet të rihartohet dhe të harmonizohet me qasjet e reja ndërkombëtare.

Projektligji për produktet ushqimore që është hartuar para rreth tri vitesh hap rrugën për krijimin e një Agjencie të vetme për produkte ushqimore dhe për konsolidimin e përgjegjësive lidhur me mbrojtjen e shëndetit publik, duke vendosur nën autoritetin e njëjtë mbrojtjen e shëndetit të shtazëve dhe të bimëve, por edhe çështjet lidhur me sigurinë e ushqimit.

Agjencia e vetme për produkte ushqimore do të ketë mandatin që të jetë autoritet ligjor dhe kompetent për mbikëqyrjen e tërë zinxhirit ushqimor, për hartimin e normave dhe standardeve dhe për të vepruar si ndërlidhës mes qeverisë dhe të gjitha palëve të tjera me interes në zinxhirin e produkteve ushqimore.

Gjithashtu, kjo Agjenci do të ketë edhe detyra të tjera, siç janë: zhvillimi dhe menaxhimi i programeve për kontrollin e ushqimit, bashkërendimin e zbatimit të njësuar të veprimtarive për kontrollin e ushqimit përmes analizës së ushqimit, inspektimit dhe aftësimeve.

Si udhëheqëse e të gjitha veprimtarive të cekura më lartë, Agjencia do të ketë autorizime që të parandalojë problemet e mundshme të sigurisë së ushqimit, por gjithashtu do të jetë në gjendje të reagojë ndaj çfarëdo emergjence dhe që t'i largojë produkte e rrezikshme ushqimore nga tregu.

-VII- Parimet dhe objektivat kryesore të BE-së në kontrollin e ushqimit

Modernizimi i legjislacionit ekzistues për kontrollin e ushqimit që ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorit dhe përmes të cilit përcaktohen kontrolli i sigurisë së ushqimit, korniza institucionale dhe përgjegjësitë e përcaktuara mirë; numër më i madh i këshillave shkencore profesionale për rrezikun dhe parandalimin e tij përmes analizave të rrezikut, kontrollit të rrezikut, si dhe menaxhimit të informatave dhe të rrezikut; qasja "prej fermës te piruni" që do të thotë të lihet anash kontrolli i produktit dhe të krijohet një sistem parandalues i kontrollit në tërë zinxhirin e prodhimit; operatorët e produkteve ushqimore tani janë përgjegjës që të dokumentojnë përcjelljen gjatë të gjitha fazave të prodhimit në kuadër të zinxhirit të prodhimit.

-VIII- Cilat janë rekomandimet për hapat e ardhshëm në kontrollin e ushqimit në Kosovë?

- Agjencia për ushqim duhet të themelohet sa më shpejtë që të jetë e mundur;
- Kjo agjenci e vetme do të merrte përgjegjësinë për mbrojtjen e shëndetit publik, duke vendosur nën një ombrellë shëndetin e shtazëve, të bimëve dhe sigurinë e ushqimit të produkteve vendore dhe të atyre nga importi;
- Parandalimi i problemeve të mundshme të sigurisë së ushqimit dhe i rreziqeve që barten përmes ushqimit;
- Krijimi i shërbimit të njësuar të inspektimit që do të përdorte të njëjtat aplikacione dhe protokolle për kontroll;
- Sistemi modern i kontrollit duhet të zbatohet përmes planit të veprimit që mund të hartohet nga një grup veprimi që do të përbëhej nga të gjitha palët me interes të sektorit (organet e larta qeveritare dhe Agjencia e tanishme për ushqim dhe veterinari e Kosovës, Inspektorati sanitar, projektet e ndryshme, shoqatat e konsumatorëve të industrisë së ushqimit, etj).
- Pas miratimit të legjislationit, është e nevojshme që industritë të fusin sistemin e vetëkontrollit;
- GMP, GHP dhe HACCP duhet të zbatohen nga industritë dhe të kontrollohen nga inspeksioni.

AGIM RYSHA, autori i artikullit është inxhinier i ushqimit dhe është afër përfundimit të studimeve padiplomike në Universitetin e Zagrebit në fushën e cilësisë dhe të sigurisë së ushqimit. Ai tani është duke punuar si ekspert lokal në projektin e GTZ-së "Përkrahje për sektorin e ushqimit në Kosovë".

Zhvillimi Rural në Kosovë

Alban ZOGAJ, MSc
Riinvest Institute

Zhvillimi Rural në përgjithësi është një proces në të cilin popullata që jeton në viset rurale i bashkon resurset e veta për të përmirësuar kushtet e jetës dhe të punës. Përmes këtij procesi dhe përmirësimit të aftësive të tyre të gjithëmbarshme, popullata që jeton në viset rurale ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të përgjithshme të tyre për të përmirësuar të ardhurat, shëndetin, shkollimin, infrastrukturën dhe shërbimet tjera sociale. Zhvillimi rural ndihmon në sigurimin e ushqimit për një pjesë të madhe të familjeve

në zonat rurale të vendeve të pazhvilluara dhe promovon zhvillimin e shëndetësisë. Zhvillimi rural gjithashtu ndihmon në gjenerimin e të ardhurave dhe krijimin e vendeve të reja të punës, dhe si i tillë është një parakusht për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.

Qasja bashkëkohore lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm rural nënkupton një qasje komplekse, e cila në vetvete përfshinë: zhvillimin e bujqësisë, shfrytëzimin racional të resurseve natyrore, zhvillimin e transportit rural, ujin dhe higjienën, zhvillimin e telekomunikimeve, zhvillimin e shkollimit, shëndetësinë dhe shërbimet sociale. Zhvillimi i bujqësisë konsiderohet të jetë një ndër sektorët kyç në zhvillimin rural në përgjithësi, sidomos kur kemi parasysh se bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik në këto rajone. Zhvillimi i bujqësisë pastaj rezulton në gjenerim të rritjes së kërkesës për sektorët tjerë të ekonomisë, si transportin rural, telekomunikimet, infrastrukturën përcjellëse, ujin e higjienën dhe shërbimet tjera sociale. Në anën tjetër, gjithmonë duhet të theksojmë se vetëm orientimi në zhvillimin e bujqësisë nuk do të rezultonte në një zhvillim rural të qëndrueshëm. Ky konstatim është shumë aktual sidomos në rastin e Kosovës, kur kemi parasysh nivelin e varfërisë dhe papunësinë në viset rurale, sipërfaqet e vogla të tokës së punueshme, afërsinë e viseve rurale me qendrat kryesore të Kosovës dhe faktorët tjerë limitues për zhvillimin e produkteve konkurruese në tregun e Kosovës. Në këtë aspekt, gjatë këtij punimi do të mundohemi të paraqesim rëndësinë e të gjithë faktorëve kryesorë të zhvillimit rural dhe ndër lidhjen shumë të fortë në mes tyre.

Aktualisht, në të gjithë rruzullin tokësor, varfëria është prezente kryesisht në vendet rurale. Si rezultat i kësaj situatë, zhvillimi rural do të qonte në zbutjen e varfërisë botërore në përgjithësi. Në Kosovë, viset rurale kanë qenë zonat më të dëmtuara gjatë luftës së vitit 1999, kështu që popullsia e saj është përballur dhe ende përballlet me vështirësi të shumta si ekonomike ashtu edhe sociale. Aktiviteti bujqësor në Kosovë ka pësuar rënie që nga ajo kohe, për shkak të dëmeve të luftës dhe për shkak të orientimit të popullsisë kah zgjidhja e problemeve të banimit. Dëmet e luftës në sektorin e bujqësisë kanë qenë të mëdha, si në objekte përcjellëse, teknologji ashtu edhe në infrastrukturë rrugore. Këto dëme kanë rezultuar pastaj në humbje të tregut, në shkatërrim të industrisë së ushqimit dhe në rënie të theksuar të rendimenteve bujqësore. Kësaj situatë në masë të madhe i ka kontribuar edhe mungesa e investimeve në bujqësi për një periudhë të gjatë kohore apo dez-investimi. Mungesa e investimeve është e pranishme edhe aktualisht në Kosovë dhe si rezultat, në Kosovë ka pasur lëvizje të mëdha të popullsisë drejt zonave urbane apo qendrave me të afërta.

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

Popullsia në Zonat Rurale në Kosovë

Në mungesë të të dhënave të sakta demografike në Kosovë, është shumë e vështirë të vlerësohet se çfarë përqindje e popullsisë së Kosovës jeton në viset rurale. Mirëpo, sipas disa vlerësimeve të fundit të Entit të Statistikave të Kosovës (ESK), vlerësohet se rreth 60% e popullsisë së Kosovës jetojnë në vise rurale. Kjo përqindje është relativisht e lartë nëse krahasohet me vendet e rajonit, ku për krahasim, në Kroaci ne zonat rurale jetojnë rreth 40% e popullsisë së Kroacisë, në Bullgari ne zonat rurale jetojnë rreth 30% e popullsisë, kurse edhe në Slloveni ne zona rurale jetojnë rreth 40% e popullsisë së Sllovenisë.

Kosova bën një përjashtim në krahasim me vendet tjera Evropiane sa i përket moshës së popullsisë. Në Kosovë një e treta e popullsisë është nën moshën 15 vjeçare. Ky është një fakt i cili kërkon vëmendje të posaçme sa i përket zhvillimit ekonomik të vendit në përgjithësi. Kjo popullatë e re kërkon shkollim dhe punësim, dhe kohëve të fundit është vërejtur një prirje e madhe për migrim si në qendrat e mëdha të Kosovës, ashtu edhe në vendet e botës perëndimore²⁴. Në përgjithësi popullsia në zonat rurale ka nivel më të ulët të arsimimit, në krahasim me popullsinë e zonave urbane. Në bazë të të dhënave të ESK-së është vlerësuar se rreth 70% e popullsisë së zonave rurale kanë shkollim primar dhe të mesëm, kurse pa arsimim fare dhe me arsimim të lartë janë vetëm rreth 5% e popullsisë. Këto të dhëna tregojnë rëndësinë dhe urgjencën që meriton zhvillimi i shkollimit në zonat rurale në Kosovë.

Papunësia në Zonat Rurale

Sipas disa studimeve të fundit (Banka Botërore, Enti i Statistikave, UNDP) vlerësohet se niveli i papunësisë në Kosovë sillet prej 40% deri 45%. Niveli i papunësisë në zonat rurale vlerësohet të jetë rreth 10% më i lartë se në zonat urbane. Si rrjedhojë, popullsia në zonat rurale është e varur në masë të madhe nga anëtarët e familjes të cilët janë të punësuar me pagë në sektorin publik apo privat (rreth 60% e të ardhurave të familjeve), nga remitancat të cilat i dërgojnë anëtarët e familjeve që jetojnë dhe punojnë në vendet perëndimore dhe nga të ardhurat të cilat i gjenerojnë nga aktivitetet bujqësore, që nuk kapin më shumë se 10% të totalit të të ardhurave²⁵. Nga këto të dhëna mund të shihet qartë që aktivitet bujqësor nuk sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për sigurimin e ekzistencës së familjeve që jetojnë në zonat rurale. Andaj një ndër prioritetet kryesore si të qeverisë ashtu edhe të sektorit privat, duhet të jetë zhvillimi i bujqësisë në mënyrë që të ardhurat nga aktivitetet bujqësore të zënë vend më të madh në totalin e

të ardhurave të familjeve që jetojnë në zonat rurale. Sipas hulumtimit të Institutit Riinvest, shumica e familjeve rurale deklarojnë që nuk kanë mjete të kursyera apo nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të financuar investimet në bujqësi. Edhe ajo pjesë e familjeve që posedon ndonjë shumë të mjeteve financiare nuk mendon se investimi në bujqësi është forma më e mirë e investimit. Duke u bazuar në këto të dhëna vërehet qartë se mundësitë e familjes rurale për të investuar në bujqësi janë shumë të kufizuara, dhe si rezultat është shumë e nevojshme që të gjenden forma të ndryshme të investimeve fillestare, në mënyrë që fermerët të fillojnë të prodhojnë më tepër për tregun e Kosovës. Rritja e nivelit të prodhimit do të hapte vende të reja të punës në zonat rurale, dhe si rezultat do të rriste nivelin e të ardhurave të familjeve që jetojnë në këto zona.

Kohëve të fundit ka pasur disa vlerësime lidhur me numrin e të punësuarve në bujqësi dhe në zonat rurale. Sipas studimeve të Bankës Botërore, në bujqësi janë të punësuar rreth 20% e totalit të të punësuarve në tregun e Kosovës. Përderisa, pjesëmarrja e sektorit të bujqësisë në GDP është rreth 25%, që në krahasim me vendet tjera është një përqindje relativisht e madhe. Ky nivel i ulët i punësimit në sektorin e bujqësisë është rezultat i madhësisë së fermave, të cilat në masë të madhe janë të orientuara në prodhim për nevoja familjare, dhe vetëm sasi të vogla të prodhimit i dedikohen tregut. Në këto vlerësime duhet të kemi parasysh edhe nivelin e ekonomisë informale në Kosovë. Konsiderohet se një pjesë e të punësuarve në sektorin bujqësor në zonat rurale nuk figurojnë të regjistruar si të punësuar.

Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka buxhet shumë të vogël në krahasim me rëndësinë dhe madhësinë e këtij sektori. Në këtë drejtim është shumë e rëndësishme që kjo ministri të ngrisë nivelin e bashkëpunimit me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, në mënyrë që ky sektor të përfitojë sa më shumë që është e mundur.

Infrastruktura Rurale

Zhvillimi infrastrukturual mund të konsiderohet si faktori më i rëndësishëm për zhvillimin rural në Kosovë. Zhvillimi i infrastrukturës i shërben qëllimeve kryesore si, përmirësimi të kushteve të jetesës, qasjes në tregje, qasjes në shkollim dhe shëndetësi, përmirësimi të prodhimit dhe thithjes së investimeve. Duke pasur infrastrukturë rurale të zhvilluar, në Kosovë pengohet edhe fenomeni i migrimit nga viset rurale drejt atyre urbane, sepse zvogëlohen diferencat ndërmjet fshatit dhe qytetit, sidomos në një hapësirë të vogël territoriale siç është ajo e Kosovës. Faktorët kryesorë

24 Early Warning Report – UNDP

25 Hulumtim i Institutit Riinvest rreth Zhvillimit Rural në Kosovë (2004)

që duhet të përmendim sa i përket zhvillimit të infrastrukturës në Kosovës janë: rrugët, uji, kanalizimi, energjia elektrike, sistemi i ujitjes, sistemi shkollor dhe ai shëndetësor.

Rrugët – Edhe pse kohëve të fundit po shohim përpetime dhe investime të shumta në rrugët rurale në Kosovë, vendbanimet rurale në përgjithësi e sidomos ato malore karakterizohen me mungesë të madhe të infrastrukturës rrugore. Ky është një ndër faktorët më limitues në rritjen e prodhimit në ato vise dhe gjithashtu një ndër faktorët kryesorë që familjet rurale të marrin vendimin për migrim drejt qyteteve më të afërta. Me mungesë të rrugëve, limitohet qasja në shërbimet sociale si, shkollimi, shëndetësia dhe shërbimet tjera publike. Problemi i transportit rrugor dhe infrastrukturës rrugore duhet të shikohet si një ndër çështjet kyçe të zhvillimit rural në Kosovë.

Uji – Aktualisht, në viset rurale në Kosovë, sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm është në gjendje të rëndë. Numri më i madh i familjeve furnizohet me ujë nga pusët me një kualitet të dyshimtë dhe të dobët të ujit. Vetëm rreth 45% e popullsisë së Kosovës ka qasje në sistemet e furnizimit me ujë, të cilat sisteme menaxhohen nga shtatë kompani rajonale.

Sistemi i Kanalizimit – Në vitet e kaluara në Kosovë nuk ka pasur investime publike të mjaftueshme në ndërtimin e sistemeve të kanalizimit në viset rurale. As në kohët e fundit gjendja nuk është me e mire. Higjiena në vendbanimet rurale është në nivel të ulët, ku në raste të caktuara ka rreziqe edhe për sëmundje të caktuara. Aktualisht, në viset rurale nuk funksionin sistemi i grumbullimit të mbeturinave, e kjo situatë vjen edhe si rezultat i infrastrukturës së dobët rrugore.

Edhe pse të gjitha vendbanimet rurale në Kosovë janë elektrifikuara dhe kanë qasje në energji elektrike, problemi kryesor qëndron në vjetërsimin e sistemeve të shpërndarjes së rrymës elektrike dhe në kapacitetet e tyre të ulta. Furnizimi me energji elektrike ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin rural, sepse një pjesë e madhe e aktiviteteve rurale dhe bujqësore janë të varura direkt nga energjia elektrike. Situata e rëndë e furnizimit me energji elektrike, si në zonat rurale ashtu edhe në përgjithësi në Kosovë, ka shtyrë fermerët të investojnë në burime alternative të energjisë, të cilat burime kanë rritur koston e prodhimit dhe kanë zvogëluar normat e profitabilitetit të tyre. Kjo rezultoi pastaj në humbje të konkurrueshmërisë me produktet e fermerëve të vendeve tjera të rajonit.

Sistemet e ujitjes në Kosovë janë gjithashtu në gjendje të rëndë, dhe paraqesin një kufizim në prodhimtarinë bujqësore. Ka mungesë të ujit dhe të sistemit të ujitjes, të cilat mungesa rezultojnë me ulje të produktivitetit dhe profit-

abilitetit të fermerëve. Nga të dhënat e Institutit Riinvest (2004), rezultoi se rreth 60% e familjeve të cilat jetojnë në zonat rurale nuk kanë mundësi të ujisin tokat e tyre, ndërkaq rreth 30% e tyre kanë mundësi të ujisin tokat e tyre vetëm pjesërisht.

Konkluzion

Nga kjo analizë mund të konkludojmë se për një zhvillim rural të qëndrueshëm në Kosovë, duhet të kemi investime më të mëdha si publike ashtu edhe private në zonat rurale. Orientimi vetëm në zhvillimin e bujqësisë në zonat rurale nuk është i mjaftueshëm për rritjen e standardit jetësor të familjeve rurale. Investimet duhet të orientohen kryesisht në zhvillim të infrastrukturës, përmirësim të mjedisit afarist në zonat rurale, zhvillim të shkollimit dhe shëndetësisë, dhe ofrim të shërbimeve publike. Për një zhvillim rural të qëndrueshëm në Kosovë, duhet të ketë më shumë investime të orientuara kah bizneset jo-bujqësore, siç mund të jetë industria e përpunimit të drurit, industria e përpunimit ushqimor dhe industria e bimëve mjekuese. Nevojiten gjithashtu lehtësira të mëdha fiskale për prodhimtarinë bujqësore, në mënyrë që produktet e prodhuara në Kosovë të jenë kompetitive me ato të prodhuara në vendet e rajonit. Duhet të përmirësohet dhe të ndryshohet urgjentisht zbatimi i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), rekomandohet që kreditimi i TVSH-së të bëhet në një periudhë kohore më të gjatë dhe jo në momentin e importimit të pajisjeve teknologjike, sepse mënyra aktuale e zbatimit të TVSH-së po i shkakton kufizime të mëdha investimeve private në zonat rurale dhe po i largon investitorët potencial të huaj.

Alban ZOGAJ, MSc
Riinvest Institute

Në kërkim të një modeli zhvillimor për të varfrit: investimet publike, bujqësia dhe varfëria rurale

Artan Loxha

Rritja në përmasa botërore e çmimeve të produkteve bujqësore është duke u rekomanduar nga disa qarqe akademike dhe politike si një mundësi për ringjalljen e ekonomisë rurale përmes forcimit të të hyrave të bujqve. Përderisa përfitimet afatgjate janë shumë të mundshme, ndikimi i çmimeve të larta të produkteve ushqimore ka gjasa që të ndryshojë varësisht nga lloji i produktit dhe rajoni gjeografik, gjë që do të kishte ndikim negativ mbi komunitetet e goditura nga varfëria, të cilat në përgjithë-

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI


si jetojnë në zonat rurale dhe janë importuese të ushqimit. Ngritja e çmimeve – e shkaktuar, në mes të tjerash, edhe nga rritja e numrit të popullsisë, kërkesa në rritje për produkte ushqimore, ndryshimet përmbajtësore të kërkesës drejt produkteve ushqimore me mbivlerë më të lartë; rendimentet më të ulëta të drithërave, furnizimi i të cilave është i kufizuar, çmimet e larta për energji, rritja e numrit të pompave për shitjen e biokarburanteve, dhe investimi i ulët sistematik në fushën e bujqësisë në shtetet në zhvillim – imponojnë kufizime disproporcionale më të larta buxhetore mbi familjet e varfra, të cilat pjesën më të madhe të shpenzimeve të tyre të përgjithshme në mënyrë tradicionale e çojnë në ushqim. Një ngritje shokuese e çmimeve e shkaktuar nga jashtë mund të shpie tek një falimentim i përgjithshëm, në të cilin të varfrit duhet të luftojnë me qëllim të mobilizimit të burimeve të tyre për të pasur qasje në një furnizim përndryshe të pakufizuar me ushqime (autori Sen, viti 1983). Pasiguria që ka lindur si pasojë e furnizimit të pamjaftueshëm me ushqime tek të varfrit mund të shkaktojë përshtatjen e strategjive të tyre të jetesës duke ua përshtatur ato fondeve të tyre të kufizuara. Në raste të tilla, mjetet institucionale përgjendjen e zgjidhjes janë shpesh të kufizuara dhe në këtë mënyrë familjeve të varfra mund t'iu duhet që të bëjnë një zgjedhje kompromisi në mes të kufizimit të nevojës të tyre konsumuese apo varfërimin të mëtejshëm të bazës së tyre materiale. (WDR, 2008).

Me paraqitjen e krizës së furnizimit me ushqime, më së shpeshti pësojnë zonat rurale – në të cilat vazhdon të sundojë në përmasa globale shkalla më e lartë e varfërisë. Në bazë të vlerës së vijës ndarëse ndërkombëtare jo edhe aq të përsosur por prapëseprapë udhëzuese të varfërisë prej një dollari në ditë, janë gjithsej 75 për qind e numrit të tërësishëm prej 1.2 miliardësh të të varfërve të rruzullit tokësor, të cilët jetojnë në zonat rurale. (WDR, 2008). Edhe pse reagoni ndaj pasigurisë që lidhet me furnizimin me ushqime në shumë shtete që kanë të ardhura të ulëta shpesh përcillet me shqetësime afatshkurtra humanitare të karakterizuara në të shumtën e rasteve me masa të papërshtatshme, të cilat përqendrohen në mobilizimin e ndihmës në ushqime dhe në krijimin e shtuar të rrugëve për ofrimin e ndihmës shoqërore, shkaktimi i pasigurisë për ushqime lidhet në mënyrë fundamentale shumë më tepër me çështjen e ngulitur strukturore të moszhvillimit dhe të lënies pas dore gjithandej të zonave rurale. Përkundër dimensioneve të shqyrtuara me kujdes të varfërisë rurale, e cila vjen si pasojë e politikave bujqësore që ndikohen me të madhe nga zhvillimet dinamike ndërkombëtare në politikë, investimi i tërësishëm i pamjaftueshëm në fushën e bujqësisë dhe lënia pas dore e saj paraqiten si pasojë e ndryshimeve të thella gjatë decenieve të kaluara në fushëveprimin, përbërjen, dhe orientimin e politikave të qeverisë për shpen-

zime më të mëdha shoqërore duke mos treguar kujdes të mjaftueshëm për sektorët e prodhimit.

Moskujdesi i treguar nga shumë qeveri për zhvillimin rural ka dobësuar dhe ka zvogëluar mundësitë e sektorit të bujqësisë për t'iu nxjerrë familjet rurale nga varfëria, në të cilën janë zhytur. Në shtete siç janë Kina dhe India, investimet shumë të mëdha të qeverisë në fushën e bujqësisë kanë shkaktuar ulje të befasishme të shkallës së varfërisë. Megjithatë, përkundër këtyre sukseseve të arritura gjatë këtyre decenieve të fundit, të cilat e sfidojnë paragjykimin e kahershëm ndaj zonave rurale, ende mbetet një rrugë e gjatë për tejkalimin e qëndrimit politik i cili vazhdon të jetë mbi-zotërues dhe i cili i nënçmon dhe i nënvlerëson mundësitë e sektorit të bujqësisë për t'iu përballur me varfërinë rurale. Disa syresh e shohin sektorin e bujqësisë si një sektor që ka një shkallë të ulët të prodhimit, me lidhje shumë më të pakta të cilat shkojnë prapa, me mundësi të vogla të zhvillimit, dhe si një sektor tradicional që vetëm shfrytëzohet pa mëshirë nga të tjerët. Strategjitë e paekuilibruara zhvillimore shpesh favorizojnë politikën e industrializimit, mundësitë prodhuese të të cilave konsiderohen të jenë më të mëdha saqë të kenë aftësinë e gjenerimit të rritjes dhe të zhvillimit të atillë, i cili në fund do të shtrihej deri tek zonat rurale. Ky paragjykim është një nga arsytet për shkak të të cilave, dukuria e varfërisë rurale vazhdon të ekzistojë edhe sot e kësaj dite. Implikimet për diskursin ende shumë të nxehtë mbi zhvillimin shkojnë në drejtim të arritjes së kompromisit në mes të rritjes në maksimum të zhvillimit të tërësishëm ekonomik nga njëra anë si dhe të rritjes deri në maksimum të zvogëlimit të shkallës së varfërisë (Osmani, 2001). Me fjalë të tjera, ulja e shkallës së varfërisë në zonat rurale varet nga stimulimi i zhvillimit të të varfërve, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë iu përket grupeve më të prekura shoqërore – ekonomike. Ekzistojnë dy arsye pse bujqësia duhet që të konsiderohet si një motor i zhvillimit të të varfërve: së pari, në vend të zhvillimit intensiv kapital pa krijimin e vendeve të punës, bujqësia mund të sigurojë vende të punës dhe sigurim të kushteve të jetesës duke qenë në masë të konsiderueshme për nga vetë natyra e saj ofruese e punës intensive, dhe së dyti, dëshmitë e fituara përmes përvojës (të cilat do të përmenden më vonë) sugjerojnë që zhvillimi që vjen nga bujqësia është më efektiv në stimulimin e rritjes së shpenzimeve për kategoritë më të varfra, sesa zhvillimi që vjen nga sektorët e tjerë jobujqësorë. Siç vëren Osmani (2001), sfidë të vërtetë paraqet lehtësimi i modelit të zhvillimit i cili *rrit në maksimum* uljen e shkallës së varfërisë. Investimi publik në sektorin e bujqësisë paraqet çelësin e kësaj përpjekjeje.

Qëllimi kryesor në këtë rast është parashtrimi i disa dëshmitëve të fituara nga përvoja dhe i argumenteve teorike që mund të ndihmojnë në planifikimin dhe në promovimin

Figura 1: Lakoret që paraqesin rritjen e shkallës së konsumit, gjatë periudhës 2003 – 2005 në Kosovë

Burimi: Banka Botërore, 2007


e objektivave të gjera të politikave me qëllim të trajtimit të varfërisë së skajshme në Kosovë përmes zhvillimit të politikave rurale. Shteti i Kosovës, me një popullsi rurale e cila përbën 60% të popullsisë së gjithëmbarshe të saj, ka shkallën më të lartë të varfërisë dhe të papunësisë në Ballkanin perëndimor: përqindja e popullsisë së varfër arrin në 45 për qind të popullsisë së përgjithshme, prej së cilës 15 për qind janë në varfëri të skajshme, të pasuar me 18 për qind tjerë të rrezikuar nga kjo varfëri (Banka Botërore, 2007). Në vitin 2005, më shumë sesa dy të tretat e të gjithë të varfërve të vlerësuar në Kosovë jetonin në zonat rurale (nga i njëjti burim). Në vitin 2005, më shumë se dy të tretat e tërë popullsisë së varfër në Kosovë jetonte në zonat rurale (nga i njëjti burim). Një shkallë më e lartë e varfërisë paraqitet tek familjet me numër më të madh të anëtarëve, me një shkallë më të lartë të varësisë dhe me nivel më të ulët të arsimimit – të gjitha këto veçori të përbashkëta të strukturës shoqërore të popullsisë rurale të Kosovës (shih të njëjtin burim). Në mes të viteve 2003 – 2005, shkalla e varfërisë në Kosovë ishte zvogëluar për pesë për qind në zonat urbane, por kjo shkallë ishte rritur për një përqindje të ngjashme nëpër zonat rurale (nga i njëjti burim: fq. 33). Kjo paraqitje statistikore, edhe pse e kufizuar, tregon se Kosova ka një shkallë të paparë të varfërisë për një shtet evropian, pjesa dërrmuese e së cilës është e përqendruar nëpër zonat rurale, në të cilat madje edhe shpenzimet e konsumit (në nivelin shtetëror) anashkalojnë xhepat e të varfërve të zonave rurale (figura 1). Kjo varfëri që mbizotëron në popullsinë rurale duket të jetë mbajtur pjesërisht nga sektori i bujqësisë, i cili – edhe pse arrin deri në së paku një të pestën e BPV –së (Bruto Prodhimit Vendor), një të tretën e numrit të tërësishëm të të punësuarve, dhe së paku 16 për qind të sasisë të përgjithshme të mallrave të eksportuara – karakterizohet nga infrastruktura e dobët nëpër zonat rurale, rrugët e dobëta, qasja e kufizuar në energji elektrike, në furnizim me ujë, shkalla e ulët e zbatimit të teknologjisë së re dhe të teknikave bashkëkohore të biznesit, shfrytëzimi jo i duhur i tokës, moskryerja e konsolidimit të tokës, shkath-

tësitë e kufizuara të marketingut në radhët e prodhuesve, mungesa e shoqatave të prodhuesve, dhe mungesa e një kornize të shëndoshë të rregullatorit (MBPZHR, 2006).

Kjo pasqyrë e zymtë dhe e pashpresë e varfërisë rurale dhe e zhvillimit të pamjaftueshëm 'kundërshtohet' përmes një strategjie të paqëndrueshme të shpenzimeve publike. Në kornizën e saj afatmesme të shpenzimeve, Qeveria e Kosovës mezi ka ndarë një përqindje prej vetëm 1.2% të buxhetit të saj shtetëror për sektorin e bujqësisë, siç shihet edhe në figurën 2, më poshtë. (MEF, 2008). Këto para publike nuk mjaftojnë për përmbushjen e objektivës së synuar të financimit të objektivave të theksuara në Master planin e Kosovës për bujqësi, duke kërkuar kështu një mbështetje shumë më të madhe të donatorëve për adresimin e një vargu të llojllojshëm të çështjeve komplekse. Këto çështje ndërlidhen me mundësimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës bujqësore përmes zbatimit të ligjeve, arritjes së konsolidimit të tokës, rritjes së investimeve në sistemet e ujitjes me qëllim të përmirësimit të shkallës së prodhimit dhe të mundësimin të konkurrencës, ofrimit të shërbimeve këshillëdhënëse, zgjerimin dhe shtrirjen e strategjive rurale, arritjen e zhvillimit të eko – turizmit, zbatimin e garantimit të standardeve të sigurisë së ushqimit, dhe përmirësimin e strukturës së pyjeve (po nga i njëjti burim). Këto shpenzime të kufizuara publike në sektorin e bujqësisë, duket se kanë pasur shembuj të ngjashëm edhe në të kaluarën. Studiuesit Fan dhe Rao (në vitin 2003) në një studim të tyre të 44 shteteve në zhvillim gjatë periudhës 1980 – 2002, konstatuan se "shpenzimet në sektorin e bujqësisë si pjesë e bruto prodhimit bujqësor vendor, kanë shënuar një rënie gjatë periudhës 1980 – 1990, [...] [të] shpenzimeve në sektorin e bujqësisë në përpjesëtim me shpenzimet e tërësishme të qeverisë, të cilat tregojnë një trend të rënies' (ZKM, 2007: 1). Kjo lënie pas dore e sektorit të bujqësisë në shtetet me të ardhura të ulëta shpesh tejkalohet nga theksimi i prioritetëve më të mëdha në sektorët e tjerë shoqërorë siç është sektori i shëndetësisë dhe ai i arsimimit.

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

Figura 2: Shpenzimet publike në bazë të sektorëve në Kosovë gjatë periudhës 2009 – 2011



Burimi: MEF, 2008

Në rastin e Kosovës, mungesa e një përkushtimi më të madh të qeverisë ndaj sektorit të bujqësisë nuk mund të arsyetohet me kufizime buxhetore. Së pari, në nivelin kuptimor – teorik, do të dukej se teoria e zgjedhjes publike ruan një pjesë të besimit lidhur me atë se qeveritë rrallë rastis të mbajnë premtimet e tyre të qarta publike për shkak të orientimit të tyre të supozuar publik. Përveç kësaj, konsideratat e ekonomisë politike, duke përfshirë këtu praktikatat për marrjen e monopolit, duket se sugjerojnë se në mungesë të veprimit të fuqishëm kolektiv në radhët e prodhuesve ruralë, politikatat qeveritare janë të prira që të reagojnë ndaj grupeve të fuqishme të interesit me agjenda jashtë fushës së bujqësisë. Bujqit kosovarë nuk kanë qenë të gatshëm gjer më tani që të ndërmarrin ndonjë veprim të përbashkët. Së dyti, Qeveria e Kosovës duket se vazhdon të mbetet e mbështjellë me të njëjtën mënyrë të të menduarit neoliberal, duke kërkuar legjitimimin e qasjes së saj të mosndërhyrjes ndaj ekonomisë me një besim naiv se tregjet private *gjithmonë* japin rezultatet më optimale shoqërore. Por, investimi në infrastrukturën e bujqësisë personifikon profite të mëdha shoqërore, duke nxitur agjentët privatë që të investojnë më pak nga frika e të qenit të paafët për t'i kufizuar efektet e jashtme. Përveç kësaj, realiteti i moszhvillimit të duhur të sektorit të bujqësisë rrallë herë korrespondon me parimet e teorisë tradicionale ekonomike: në veçanti për shkak të arsyes se shtetet me të ardhura të ulëta karakterizohen me përhapjen e tregjeve të humbura dhe të atyre jo të plota, përfshirë këtu edhe reagimet joefikase të tregut të cilat nxitin nga mospërputhja e informatave, gjë e cila mund të pengojë qasjen aq shumë të dëshiruar në tregjet e kredive dhe të sigurimeve.

Së treti, ripërtëritjet institucionale në Kosovë janë të shtyra nga nevoja për t'i miratuar praktikatat e rregullatorit të njëjta me ato të botës perëndimore, gjë e cila kufizon fushëveprimin e ndërhyrjes qeveritare të planifikuar mirë, e cila është e nevojshme për adresimin e kushteve të pranishme në

ekonomitë me strukturë të pazhvilluar. Së katërti, qeveria ka nënkontraktuar në mënyrë të efektshme pronësinë e politikave të saj zhvillimore rurale tek aktorët kyç shumëpalësh, d.m.th. tek BE-ja. Lehtësia me të cilën gjer më tani është bërë një gjë e tillë bazohet në besimin se objektiva afatgjatë strategjike e Kosovës mbetet anëtarësimi në BE dhe megjithëse Kosova e ka mirë kur synon që të konfigurujë politikatat e saj rurale duke u mbështetur në praktikatat zhvillimore rurale të BE-së, një gjë e tillë nuk duhet që të shfaqësojë qeverinë nga një përkushtim sipërfaqësor apo shumë i përgjithësuar qoftë ai afatshkurtër apo afatgjatë ndaj investimeve në fushën e bujqësisë duke shfrytëzuar burimet e saj vetjake. Edhe pse mungesa organizative dhe drejtuese e qeverisë së tanishme ka mundësi që të interpretohet si mundësi e kufizuar e saj për të tërhequr fonde nga BE-ja, është po ashtu e vërtetë se burimet vetjake të qeverisë po përdoren më lehtë për çështje specifike të cilat synojnë adresimin e zhvillimit të pamjaftueshëm rural, i cili përndryshe do të kërkonte përbushjen e kushteve të rrepta për sigurimin e fondeve nga ana e donatorëve të shumanshëm. Përkundër efektit indirekt dhe të gërshtuar të investimit në sektorët e tjerë, detyrimet shumë të kufizuara publike financiare të qeverisë ndaj sektorit të bujqësisë sjellin në pikëpyetje përkushtimin e saj në përdorimin e fondeve vendore për zhvillimin e bujqësisë (ZKM, 2007).


Perspektiva e rritës ekonomike që do t'i nxirrte komunitetet rurale nga varfëria në Kosovë, është duke u forcuar nga fakti se varfëria në Kosovë është e cekët për nga natyra e saj, e kombinuar me një pabarazi të të ardhurave të ulëta (Banka Botërore, 2007). Kjo gjë nënkupton se zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik gjatë një periudhe disaveqare përbush premtimin për uljen e shkallës së varfërisë për shkak të elasticitetit të lartë të rritjes së varfërisë (nga po i njëjti burim). Megjithatë, sfida kryesore është të fillohet me një strategji zhvillimore e cila *shpie në maksimum* uljen e shkallës së varfërisë. Arsyeya pse sektori i bujqësisë duhet

që të jetë pretenduesi kryesor për trajtimin e varfërisë së skajshme ka të bëjë me shumë arsye. Së pari, sektori i bujqësisë ka një potencial shumë të madh për aktivitetet intensive të punës. Përkundër pesimizmit të shprehur në lidhje me mundësinë e zhvillimit të bujqësisë nga ana e ekonomistëve të hershëm siç ishte Hirschman (në vitin 1958) si dhe argumenteve se bujqësia ka lidhje të ulëta prapa, potenciali i shkallës së ulët të prodhimit krahasuar me industritë e tjera, dhe efektet e ulëta të rritjes, duke përfshirë kushtet tradicionalisht në rënie të tregtisë që u mundësojnë bartje efektive shteteve të pasura, revolucionet bujqësore që japin ngritje të shpejtë të shkallës së prodhimit (siç është rasti me Revolucionin e gjelbër) kanë qenë të një rëndësie thelbësore për propagandimin e zhvillimit industrial (autorët Anriquez dhe Stamoulis, 2007).

Së dyti, “përqendrimi i vazhdueshëm i varfërisë në zonat rurale ilustron vështirësinë e shpërndarjes së të ardhurave të prodhuara jashtë sektorit të bujqësisë dhe apatinë e thellë në transformimin profesional të njerëzve në procesin e ristrukturimit të ekonomive’ (WDR, viti 2008: fq. 29). Së treti, që është më e rëndësishmja, “81 për qind e shkallës botërore të uljes së varfërisë rurale gjatë periudhës 1993 – 2002 mund t’i përshkruhen përmirësimit të kushteve në zonat rurale; migrimi arrinte shkallën prej 19% të uljes së kësaj shkalle” (WDR, viti 2008: fq. 30). Përveç kësaj, të dhënat e fituara nga matematika ekonomike sugjerojnë që bujqësia ka një përparësi të dukshme në luftimin e varfërisë: “në një studim të kryer në 42 shtete në zhvillim gjatë periudhës 1981 – 2003, një rritje prej një për qind e BPV – së në bujqësi ka rritur shpenzimet e tri dhjetëshave më të varfër për së paku 2.5 herë më shumë sesa rritja e krijuar në pjesën tjetër të ekonomisë” (nga po i njëjti burim: fq. 30) (figura 3). Një studim i kryer nga autorët Bravo – Ortega dhe Lederman (në vitin 2005) po ashtu konstatuan se rritja e BPV – së si rezultat i rritjes së shkallës së prodhimit nga puna me bujqësi “është mesatarisht 2.9 herë më efektiv në ngritjen e të ardhurave të pesësesh më të varfër në shtetet në zhvillim’ (WDR: fq. 30).

Zotimi i qeverisë për investim më të madh në sektorin e bujqësisë, për këtë arsye, arsyetohet me faktin se zhvillimi i nisur në bujqësi dhe jo në sektorët e tjerë, është më i “pajisur” për të rritur të ardhurat e shtresës më të varfër në zonat rurale. Kjo gjë nënkupton që politikat e përgatitura si duhet në sektorin e bujqësisë, të cilat synojnë zhvillimin rural mund të shfrytëzohen si një instrument më efektiv për uljen e shkallës së varfërisë rurale. Edhe pse çështja e pazgjidhur lidhur me atë se cilat politika specifike në fushën e bujqësisë janë të nevojshme me qëllim të arritjes së uljes më të ndjeshme të shkallës së varfërisë rurale është lënë detyrimisht e patrajtuar në këtë studim për shkak të qenit më të shkurtër, është me rëndësi të

Figura 3: Të ardhurat nga ndihmat sociale si pasojë e zhvillimit në sektorin e bujqësisë dhe në sektorët jobujqësorë



Source: Ligon and Sadoulet 2007.

Note: The two curves are significantly different at the 95 percent confidence level for the lowest five expenditure deciles.

Burimi: WDR, viti 2008

nënvizohet theksimi i rëndësisë së investimeve të qëndrueshme publike në sektorin e bujqësisë. Një shembull lidhur me këtë është India: shkalla e varfërisë së popullsisë së saj rurale ka shënuar një rënie prej 65% sa ishte në mes të viteve të 60 –ta në një të tretën e popullsisë rurale në fillim të viteve të 90 –ta. (IFPRI, viti 1999). Ulja e shkallës së varfërisë është e lidhur fort me Revolucionin e gjelbër i cili ka ardhur si pasojë e investimeve masive publike në sektorët bujqësorë ruralë (nga po i njëjti burim). Shpenzimet publike të qeverisë indiane në kërkime të kryera në fushën e bujqësisë dhe në përhapjen e saj, gjë që ka shtuar shkallën e prodhimeve bujqësore, së bashku me investimet në infrastrukturën rurale siç janë rrugët dhe shkollimi, dhe zhvillimi rural që si synim ka të varfrit kanë stimuluar ulje të ndjeshme të shkallës së varfërisë (nga po i njëjti burim). Edhe pse ekzistojnë shqetësime të bazuara lidhur me kontekstin relativ të politikave bujqësore indiane si dhe të zbatimit të tyre të mundshëm diku tjetër, argumenti i parashtruar këtu, përkundër faktit se nënkupton një nivel të caktuar të determinizmit të investimeve publike, thekson nevojën për të provuar një endogjenizim më rigoroz shkollor të mekanizmit përmes të cilit investimet publike në sektorin e bujqësisë faktikisht ia dalin në trajtimin më efektiv të varfërisë rurale sesa zhvillimi i krijuar nga sektorët e tjerë jobujqësorë. Problemi qëndron thjesht në atë se edhe pse shtetet me të ardhura të ulëta ndjekin modelin zhvillimor perëndimor hap – pas – hapi të transformimit strukturor në drejtim të zhvillimit industrial, shkallët e varfërisë në zonat rurale vazhdojnë të mbeten të njëjta. Prej kësaj rrjedh një rekomandim i thjeshtë: ulja e shkallës së varfërisë rurale varet nga zotimi i qeverisë për të miratuar një model të strategjisë zhvilli-

ZHVILLIMI dhe TRANZICIONI

more e cila në vetë thelbin e saj përmban uljen e shkallës së varfërisë rurale. Çelësi i kësaj është përqendrimi në zhvillimin e sektorit të bujqësisë përmes investimeve më të mëdha publike. Megjithatë, paraqitjet e shpenzimeve qeveritare në shumë shtete në zhvillim edhe sot e kësaj dite nuk korrespondojnë me këtë qasje dhe as Kosova nuk paraqet përjashtim nga kjo rregull.

Referencat

Autorët Anriquez, G. dhe Stamoulis, K. 2007 *Zhvillimi rural dhe ulja e shkallës së varfërisë: A është ende çelës bujqësia?* Dokumentet punuese 07-02, Organizata për ushqim dhe bujqësi.

Bravo-Ortega, C. Dhe Lederman, D. 2005. *Bujqësia dhe mirëqenia shtetërore nëpër botë: Parimi shkak – pasojë dhe heterogjeniteti ndërkombëtar që nga viti 1960.* Politikat e Bankës Botërore, Dokumenti i punës, seria 2499.

Fan S dhe autorë të tjerë. 1999. *Lidhjet në mes të shpenzimeve të qeverisë, zhvillimit dhe varfërisë në Indinë rurale.* Instituti ndërkombëtar për kërkime të politikave që kanë të bëjnë me ushqimin.

Fan, S. Dhe Rao, N. 2003. *Shpenzimet publike në shtetet në zhvillim: Tendencat, përcaktimi dhe efekti.* Dokumenti për diskutim nr. 99 i EPTD –së, IFPRI.

Ligon, E. Dhe Sadoulet. 2007. *Vlerësimi i efekteve të zhvillimit të përgjithshëm të bujqësisë në shpërndarjen e shpenzimeve.* Dokument informativ për Raportin zhvillimor botëror për vitin 2008.

MBPZHR. 2006. *Bujqësia dhe plani për zhvillimin rural, 2007-2013.*

MEF. 2008. *Korniza afatmesme e shpenzimeve për periudhën 2009 - 2011, në Kosovë.* Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, Kosovë.

ZKM, Udhëzime. 2007. *Rënia e shkallës së shpenzimeve publike në sektorin e bujqësisë – a ka rëndësi një gjë e tillë?* Menaxhimi i politikave të Oksfordit.

Osmani, S.R. 2001. *Strategjitë për zhvillim dhe ulja e shkallës së varfërisë.* Forum mbi varfërinë në Azi dhe në Paqësor.

Sen, A. 1983. *Varfëria dhe krizat e urisë: Ese mbi dhënien dhe marrjen e të drejtës.* Oxford University Press

Banka Botërore. 2008. *Bujqësia për zhvillim.* Raporti zhvillimor botëror për vitin 2008.

Banka botërore. 2007. *Vlerësimi i shkallës së varfërisë në Kosovë: Vëllimi I: Përshpejtimi i zhvillimit gjithëpërfshirës me qëllim të uljes së varfërisë së gjithëmbarshme.* Njësia për ulje të shkallës së varfërisë dhe për menaxhim ekonomik.



United Nations
Payton Place 14,
10000 Pristina, Kosovo

Tel: ++381 38 249 066
Fax: ++381 38 249 065
www.ks.undp.org